



Ludwig Boltzmann Institute of Human Rights
Research Association (BIM-FV)

Austrian

Development Cooperation



KORNIZA LIGJORE NDËRKOMBËTARE DHE KOMBËTARE PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË MAQEDONI

Korniza ligjore ndërkombëtare dhe kombëtare për të drejtat e njeriut në Maqedoni



Ludwig Boltzmann Institute of Human Rights
Research Association (BIM – FV)

Austrian
Development Cooperation



Përgaditja dhe botimi i doracakut janë të përkrahur nga Agjencia austriake për zhvillim përmes Ludvig Boltzman Insitutit për të drejtat e njeriut dhe UNDP

Përgaditur nga

As. prof. Jovan Ananiev, D.Sh.
Helmut Saks, M.A, Hulumtues Juridik

Përkthimi

Mirije Sulmati

Lekturimi

Agim Mustafai

Dizajn i kornizës dhe shtypja

ARCUSS Fonko Design

ISBN 9989-2536-3-3

Projekt

Të drejtat e njeriut dhe varfëria në Maqedoni

Address: Nikola Vapcarov II/4-4, 1000 Skopje

Tel: (389 2) 32 16 982

Zyra e projektit

Filippo Unterhofer

Mirije Sulmati

Ninoslav Mladenovic

Jagoda Strasevska

Abdikim

Qëndrimet e shfaqura në këtë doracak janë qëndrime të autorëve që nuk do të thotë se janë qëndrime të Programit për zhvillim të Kombeve të Bashkuara ose Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara lidhur me statutin ligjor ose emërin e cilit do shteti, teritori, qyteti ose rrethine, ose për autorët e tekstit.

Qëllimi kryesor i këtij dokumenti është që të japë një spektër të gjerë dhe të qartë të normave dhe standardeve të rëndësishme, të përfshira me të drejtën kombëtare dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Maqedoni.

Duke i marrë parasysh hapat e Republikës së Maqedonisë për implementimin e Objektivave zhvillimore të mijëvjeçarit dhe përkushtimin e Qeverisë për zbatimin e procesit të integritimit në BE, në të cilin proces është i kyçur edhe rishqyrtimi i mbrojtjes të drejtave të njeriut, ky dokument synon:

- të mbështesi identifikimin e sfidave të të drejtave të njeriut, të cilat mund të jenë pengesë për procesin lokal dhe nacional të planifikimit dhe implementimit.
- të qartësojë rolin e bartësve të të drejtave dhe të obligimeve, përgjegjësi dhe kompetencave të qeverisë lokale-nacionale dhe aktorëve të tjerë dhe në të njëjtën kohë ta paraqet nevojën për bashkëpunim dhe partneritet për aksion të përbashkët të këtyre aktorëve
- të mbështet identifikimin e grupeve në kuadër të popullatës të cilat gjenden në situata të rënda-të veçanta-margjinalizuara
- të promovojë vetëdije dhe mirëkuptim të parimeve të të drejtave të njeriut, të tregojë gjithanshmëri në qasjen kah të drejtat e njeriut të bazuara në të drejta qytetare, kulturore, ekonomike, politike dhe sociale, me theks të veçantë për të drejtat e gruas dhe fëmijës dhe të kontribuoj për një „kulturë respekti të të drejtave të njeriut“

Objektivat zhvillimore të mijëvjeçarit janë botërore, me kohë të limituar dhe objektiva të kuantifikuara për trajtimin e varfërisë së skajshme në të gjitha dimensionet e saj - varfëria, uria, sëmundjet, mospasja e banimit adekuat dhe marginalizimi - njëkohësisht duke promovuar barazi gjinore, arsim dhe qëndrueshmëri ekologjike. Në realitet ato, gjithashtu janë edhe të drejtat themelore të njeriut - e drejta për shëndet, arsim, strehim dhe siguri të çdo personi - siç është përpjekja në Deklaratën Universale për të drejtat e njeriut (Universal Declaration of Human Right) Deklarata e Mijëvjeçarit e KB (UN Millenium Declaration). Kjo lidhje e qartë është më detalisht e sqaruar në rekomandimet e propozuara të KB-ve për qasjen deri te të drejtat e njeriut dhe strategjitë për zvogëlimin e varfërisë (Propozim-rekomandime për varfërinë) të cilat janë të përdorura si një mjet referues në këtë dokument.

Si përfundim, qasja deri te të drejtat e njeriut shton një kornizë normative obliguese për zhvillim dhe përpjekje për uljen e varfërisë lidhur me autorizimet dhe përgjegjësitë.

Më detalisht, ajo mund të sqarohet si vlerë e shtuar në qasjen e bazuar në të drejtat e njeriut:

- Fillon nga normativja, korniza ligjore: kërkimi i të drejtave, përmbushja e obligimeve - pa mos u bazuar në mëshirë dhe zemërgjerësi
- Korniza ligjore ndërkombëtare dhe kombëtare tashmë ekzistojnë: pavarësisht nga zgjedhja e Qeverisë ose programit zhvillimor, përkundrazi ato duhet t'i respektojnë obligimet e tyre ligjore

- Shfrytëzimi i kornizës ligjore, gjithashtu e rrit legjitimitetin e masave, të cilat janë të miratuara universalisht në disa nga marrëveshjet për të drejtat e njeriut (siç është Konventa për të drejtat e fëmijës)
- Duke i bërë evidente të drejtat e njeriut, forcohet edhe sundimi i së drejtës dhe ndihmohet në qartësimin e përgjegjësi-ve
- Ka për qëllim t'i forcojë si bartësit e të drejtave, ashtu edhe bartësit e obligimeve
- Monitorimi i vazhdueshëm kërkon mbledhjen e informatave relevante dhe zhvillimin e treguesve
- Ai thërret në qasje të gjithanshme, strategjike, qasje të orientuara në kontekst të analizave, organizimin e prioritetëve, zhvillimin e politikës dhe programit, monitorimin dhe vlerësimin por gjithashtu përdorimin e një spektri të gjerë të instrumenteve (presion nga popullata, ngritje e vetëdijes, konspiracion idesh, trajnim etj.) dhe partneritet me të gjithë aktorët



Karakteristikat e përgjithshme të kornizës ligjore për të drejtat e njeriut në Maqedoni

1. Nivel ndërkombëtar

Maqedonia i ka miratuar gati të gjitha marrëveshjet për të drejtat e njeriut në nivel evropian dhe ndërkombëtar (shih tabelat për ratifikim më poshtë, me detaje për konventat e KB-ve, Organizatës ndërkombëtare për punë, UNESCO dhe të Këshillit të Evropës; të gjitha të dhënat janë vlefshme nga 1 prill 2006)

1.1 Standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut

Duke aprovuar detyrime ligjore, Maqedonia është shtet/palë e marrëveshjeve të poshtëshënuara për të drejtat e njeriut të KB-ve:

Konventa	Nënshkrimi	Miratim/ Monitorim/ Qasje	Hyrja në fuqi
Pakti ndërkombëtar për të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore (International Covenant on Economic, Social and Cultural Rights (CESCR) 1966		18/01/1994 (monitorim)	17/09/1991
Pakti ndërkombëtar për të drejtat qytetare dhe politike (International Covenant on Civil and Political Rights (CCPR) 1966 (përgjegjësi e pa miratuar për ankesat ndërshtetërore (neni 41)		18/01/1994 (monitorim)	17/09/1991
Protokolli plotësues i CCPR, viti 1966 (Optional Protocol to the CCPR)		12/12/1994 (qasje)	12/03/1995
Protokolli i dytë plotësues i ICCPR, viti 1989 (Second Optional Protocol to ICCPR)		26/01/1995 (qasje)	26/04/1995
Konventa kundër torturës dhe llojeve tjera të sjelljes jonjerëzore dhe nënçmuese ose dënimet (Convention Against Torture and Other Cruel Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CAT)) 1984 (kompetencë e miratuar për veprimin hulumtues, ankesa individuale/ ndërshtetërore (nenet 20, 21, 22)		12/12/1994 (monitorim)	17/09/1991
Protokoll plotësues i CAT, viti 2002 (Optional Protocol to CAT)	---	---	---
Konventa për të drejtat e fëmijës, viti 1989 (Convention on the Rights of the Child (CRC))		2/12/1993 (monitorim)	17/09/1991
Protokolli plotësues i CRC për përfshirjen e fëmijëve në konflikt të armatosur, viti 2000	17/07/2001	12/01/2004	12/02/2004

Protokolli plotësues i CRC për tregtinë me fëmijë, prostitucionin e fëmijëve dhe pornografinë fëmijërore, viti 2000	17/07/2001	17/10/2003	17/11/2003
Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të femrave, viti 1979		18/01/1994 (monitorim)	17/09/1991
Protokolli plotësues i CEDAW, viti 1999 (Optional Protocol to CEDAW)	03/04/2000	17/10/2003	17/1/2004
Konventa ndërkombëtare për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor, viti 1965 (Ingerencë e pranuar për ankesat individuale neni 14)		18/01/1994 (monitorim)	17/09/1991
Konventa ndërkombëtare për mbrojtjen e të gjithë punëtorëve - emigrantëve dhe anëtarëve të tyre të familjes, viti 1990	---	---	---

Maqedonia i ka ratifikuar këto të ashtuquajtura Konventa themelore të ONP (ILO) (data e miratimit është dhënë më poshtë):

Liria e asociimit dhe negocimit kolektiv (Freedom of association and collective bargaining)		Eliminimi i punës së dhunshme dhe të detyrueshme (Elimination of forced and compulsory labour)	
Konventa No. 87	Konventa No. 98	Konventa No. 29	Konventa No. 105
17/11/1991	17/11/1991	17/11/1991	15/07/2003

Eliminimi i diskriminimit gjatë punësimit dhe profesionit (Elimination of discrimination in respect of employment and occupation)		Zhdukja e punës fëmijërore (Abolition of child labour)	
Konventa No. 100	Konventa No. 111	Konventa No. 138	Konventa No. 182
17/11/1991	17/11/1991	17/11/1991	30/05/2002

Sa i përket konventave relevante të UNESCO-s, Maqedonia i ka miratuar këto konventa

Konventa kundër diskriminimit në arsim viti 1960.	30/04/1997 (monitorim)
Konventa për arsim të orientuar dhe arsim profesional viti 1989	---
Konventa për mbrojtjen dhe promovimin e shprehjes së ndryshme kulturore 2005	---

Duke krijuar obligim juridik, Maqedonia është shtet/palë e marrëveshjeve të lidhura nën patronazhin e Këshillit Evropian që merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të dhëna në tabelë:

	Nënshkrimi	Miratimi/ Monitorimi/ Qasja	Hyrja në fuqi
Konventa Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, viti 1950.	9/11/1995	10/4/1997	10/4/1997
Protokolli KEDNj (Protocol to the ECHR) 1952.	14/6/1996	10/4/1997	10/4/1997
Protokolli nr. 2 i KEDNj, që ka të bëjë me përgjegjësitë e Gjyqit Evropian për të drejtat e njeriut për të dhënë mendime këshillëdhënëse 1963.	9/11/1995	10/4/1997	10/4/1997
Protokolli nr. 3 kah KEDNj, me të cilin ndryshohen nenet 29, 30 dhe 34 të Konventës së viti 1963.	9/11/1995	10/4/1997	10/4/1997
Protokolli nr. 4 kah KEDNj, me të cilën sigurohen disa të drejta dhe liri të ndryshme nga ato të cilat janë të kyçura në Konventën, dhe me atë në protokollin e parë, 1963.	14/6/1996	10/4/1997	10/4/1997
Protokolli nr. 5 i KEDNj me të cilin ndryshohen nenet 22 dhe 40 të Konventës së vitit 1966.	9/11/1995	10/4/1997	10/4/1997
Protokolli nr. 6 i KEDNj për anulimin e dënimit me vdekje, viti 1983	14/6/1996	10/4/1997	1/5/1997
Protokolli nr. 7 i KEDNj, viti 1984	14/6/1996	10/4/1997	1/7/1997
Protokolli nr. 8 i KEDNj 1985	9/11/1995	10/4/1997	10/4/1997
Protokolli nr. 11 i KEDNj rristrukturim i makinerisë kontrolluese të vendosur atje, viti 1994	9/11/1995	10/4/1997	1/11/1998
Protokolli nr. 12 i KEDNj, viti 2000	4/11/2000	13/7/2004	1/4/2005
Protokolli nr. 13 i KEDNj për anulimin e dënimit me vdekje në të gjitha rastet, viti 2002	3/5/2002	13/7/2004	1/11/2004
Protokolli nr. 14 i KEDNj me të ndryshohet sistemi kontrollues i Konventës së vitit 2004.	15/9/2004	15/6/2005	Protokolli ende nuk ka hy në fuqi
Konventa Evropiane për ndërprerjen e torturës dhe sjelljes johumane dhe degraduese ose dënimit viti 1987	14/6/1996	6/6/1997	1/10/1997
Protokolli nr. 1 i Konventës Evropiane për ndërprerjen e torturës dhe sjelljes johumane dhe degraduese ose dënimit, viti 1993	14/6/1996	6/6/1997	1/3/2002
Protokolli nr. 2 i Konventës Evropiane për ndërprerjen e torturës dhe sjelljes johumane dhe degraduese ose dënimit, viti 1993	14/6/1996	6/6/1997	1/3/2002
Akti Sociale Evropiane, viti 1961.	5/5/1998	31/3/2005	30/4/2005
Protokolli plotësues i Kartës Sociale Evropiane (Additional Protocol to the European Social Charter), viti 1988.	5/5/1998	---	---
Protokolli për ndryshimin e Kartës Sociale Evropiane viti 1991.	5/5/1998	31/3/2005	Protokolli ende nuk ka hy në fuqi
Protokolli plotësuesi i Kartës Sociale Evropiane i cili mundëson sistem për ankesa kolektive viti 1995.	---	---	---
Akti Sociale Evropiane – i reviduar viti 1996.	---	---	---

Konventa Evropiane për adoptimin e fëmijëve viti 1967	3/4/2001	15/1/2003	16/4/2003
Konventa evropiane për statusin juridik të fëmijëve jashtëmartesorë viti 1975	3/4/2001	29/11/2002	1/3/2003
Konventa Evropiane për miratimin dhe zbatimin e vendimeve për kujdestarinë mbi fëmijët dhe për kthimin e kujdestarisë mbi fëmijët viti 1980	3/4/2001	29/11/2002	1/3/2003
Konventa Evropiane për zbatimin e të drejtave të fëmijëve viti 1996	3/4/2001	15/1/2003	1/5/2003
Konventa për kontaktet që kanë të bëjnë me fëmijët viti 2003	---	---	---
Akti evropian për gjuhët e pakicave dhe gjuhët rajonale viti 1992.	25/7/1996	---	---
Konventa sistemore për mbrojtjen e pakicave kombëtareviti 1995	25/7/1996	10/4/1997	1/2/1998
Konventa e Këshillit të Evropës për aksion kundër regjisë me njerëz viti 2005	17/11/2005	---	Konventa ende nuk ka hy në fuqi

1.2 Monitorimi ndërkombëtar për Maqedoninë

Për shkak të pranimit të një spektri të gjerë të obligimeve ndërkombëtare në bazë të Konventave për të drejtat e njeriut, Maqedonia, gjithashtu është subjekt i një spektri të gjerë të mekanizmave ndërkombëtare për monitorim: ato i imponojnë shtetit obligimin për të dërguar raporte (p.sh.: në bazë të marrëveshjeve të KB-ve, Akti Sociale Evropiane, Konventa kornizë për pakicat kombëtare), mekanizma ankuese (të parashikuara në disa konventa të KB-ve dhe Konventës evropiane për të drejtat e njeriut) procedura hetuese (p.sh. në bazë të regjimit të Konventës Evropiane për pengimin e torturës). Përveç kësaj, ekzistojnë disa mekanizma të cilat nuk janë të miratuara, p.sh. në sektorin e procedurës speciale (grupe punuese, reporterë specialë etj.) nga Komisioni për të drejtat e njeriut të KB-ve ose Komisioni Evropian kundër racizmit dhe jo tolerancës (European Commission against Racism and Intolerance – ECRI); përveç kësaj, në këtë kategori mund të merren parasysh edhe aktivitetet e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE).

2. Niveli nacional

2.1 Standardet vendore - Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë

Në bazë të nenit 118 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare që janë miratuar në pajtim me Kushtetutën, janë pjesë e legjislativës vendore dhe nuk mund të ndryshohen me ligj. Në këtë mënyrë, në rendin hierarkik të normave ligjore, marrëveshjet ndërkombëtare janë mbi ligjet vendore. Prej këtu del edhe detyra për harmonizim të sistemit juridik dhe praktikës së gjyqeve, administratës publike dhe organeve tjera shtetërore, me standardet që dalin nga konventat dhe praktika e organeve të tyre. Procesit të ratifikimit të dokumentit ndërkombëtar, i paraprin hulumtim i aftësisë së rregullativës ligjore, ku konstatohen implikacionet ligjore.

Marrëveshjet ndërkombëtare në sistemin tonë juridik, paraqesin burim të së drejtës, ashtu që individët-subjekte në drejtësi, munden automatikisht të thirren në dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare, ndërsa gjyqet dhe organet udhëheqëse

janë të obliguara t'i praktikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Marrëveshjet për të drejtat e njeriut, kanë fuqi më të lartë ligjore nga marrëveshjet tjera ndërkombëtare. Deri te ky konkluzion, pa dyshim na shpie edhe neni 8 paragrafi 1 alineja 1 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, në të cilën si një nga vlerat më të larta të rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë është respektimi i lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe qytetarit, të miratuara në të drejtën ndërkombëtare dhe të vërtetuara me Kushtetutën.

Kushtetuta përmban një listë të përgjithshme të të drejtave themelore nga neni 9 deri te neni 48 duke i përfshirë të drejtat qytetare, kulturore, ekonomike, politike dhe sociale.

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë – Liritë fundamentale

(Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë është e botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr: 52/1991; Amendamentet I dhe II janë të botuara në Gazetën Zyrtare të R.;Maqedonisë nr.1/1992 ; Amendamenti III është i botuar në Gazetën Zyrtare të R. Maqedonisë nr. 31/1998; Amendamentet IV, V, VI, VII, VIII, IX, X, XI, XII, XIII, XIV, XV, XVI, XVII dhe XVIII janë të botuara në Gazetën Zyrtare të R. Maqedonisë nr .91/2003)

- Barabarësia e qytetarëve- Neni 9
- E drejta në jetë - Neni 10
- Integriteti i personit- Neni 11
- E drejta e lirisë - Neni 12
- Supozimi i pafajësisë - Neni 13
- Ngritja e padisë në bazë të drejtësisë - Neni 14
- E drejta e ankesës - Neni 15
- E drejta e bindjes, fjalimit dhe qasja deri te informatat - Neni 16
- Fshehtësia e korrespondencës - Neni 17
- Siguria e informatave personale - Neni 18
- Liria e religjionit - Neni 19
- Liria e grumbullimit - Neni 20
- E drejta e grumbullimit- Neni 21
- E drejta e votës - Neni 22
- E drejta e zyrës publike- Neni 23
- E drejta e petitionit - Neni 24
- E drejta e privatësisë – Neni 25
- E drejta e mosdëmtimit të shtëpisë - Neni 26
- E drejta e lëvizjes - Neni 2
- E drejta dhe obligimi i mbrojtjes së shtetit - Neni 2
- Të drejtat e qytetarëve të huaj në R. Maqedonisë - Neni29
- E drejta e pronësisë - Neni30
- E drejta e punës - Neni32
- Obligimi i pagimit të taksave - Neni33
- E drejta e mbrojtjes sociale - Nenet 34, 35, 36
- E drejta e bashkimit sindikal - Neni 37
- E drejta e protestës - Neni 38
- E drejta e mbrojtjes shëndetësore - Neni 39
- Mbrojtja e familjes - Neni 40
- Liria e krijimit të pasardhësve - Neni 41
- Mbrojtja e nënave dhe fëmijëve - Neni 42

- E drejta e jetës në një ambient të shëndoshë - Neni 43
- E drejta e arsimit - Nenet 44, 45, 46
- E drejta e shprehjes së lirë shkencore dhe artistike - Neni 47
- Liria e shprehjes së nacionalitetit - Neni 48

2.2 Struktura për mbrojtjen dhe monitorimin e të drejtave të njeriut

2.2.1 Mbrojtja e lirive dhe të drejtave përpara Gjyqit Kushtetues të Republikës së Maqedonisë

Përpos gjyqeve themelore, mbrojtje direkte e lirive dhe të drejtave të njeriut mund të realizohet edhe përpara Gjyqit Kushtetues të Republikës së Maqedonisë. Në bazë të nenit 110 paragrafi 1 alineja 3 nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Gjyqi Kushtetues i mbron liritë dhe të drejtat e njeriut të cilat kanë të bëjnë me liritë e bindjes, ndërgjegjes, mendimit dhe shprehjes publike të mendimit, bashkimit politik dhe veprimi dhe ndalimi i diskriminimit të qytetarëve në bazë të gjinisë, racës, religjionit, nacionalitetit ose përkatësisë sociale dhe politike. Me këtë instrument që quhet padi Kushtetuese, deri tash gjyqi Kushtetues ka vendosur për 80 padi për shkeljen e të drejtave të njeriut. Gjyqi Kushtetues i Republikës së Maqedonisë, në të shumtën e rasteve duke vendosur për pajtueshmërinë e ligjeve me Kushtetutën, faktikisht akteve ndërligjore me Kushtetutën dhe ligjet, në të shumtën e rasteve ka shfuqizuar disa rregullativa nga ligjet dhe rregulla tjera me të cilat janë shkelur të drejtat e qytetarit dhe liritë e garantuara me Kushtetutë

2.2.2 Sistemi gjyqësor për mbrojtjen e të drejtave të njeriut

Disa rregulla kushtetuese për gjyqësinë

Neni 98

Pushtetin juridik e kryejnë gjyqet. Gjyqet janë autonome dhe të pavarura. Gjyqet vendosin në bazë të Kushtetutës dhe kontratave ndërkombëtare të miratuara në pajtueshmëri me Kushtetutën. Organizata e gjyqeve është e vetme. Janë të ndaluara gjyqet e jashtëzakonshme.

Neni 101

Gjyqi suprem i Republikës së Maqedonisë është gjyqi më i lartë në kuadër të Republikës dhe e siguron unitetin në implementimin e ligjeve nga ana e gjyqeve.

Neni 102

Debatet para gjyqeve dhe shqiptimi i dënimit janë publike. Publiku mund të përjashtohet në raste të përcaktuara me ligj

Kompetencat e Gjyqit suprem të Republikës së Maqedonisë

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë e definojnë Gjyqin suprem të Republikës së Maqedonisë si gjykatën më të lartë në këtë shtet e cila e siguron unitetin në zbatimin e ligjeve nga ana e gjyqeve. Kjo gjykatë e implementon pushtetin juridik në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë, ndërsa selia e saj është në Shkup.

Gjyqi suprem ka Sekretar, tre seksione gjyqësore (seksionin për vepra ndëshkuese, seksionin për vepra qytetare dhe seksionin për konteste administrative), qendër për informatikë, evidentim të praktikës dhe edukimit gjyqësor dhe shërbimin profesional.

Gjyqi suprem është kompetent të

- Vendos në shkallën e dytë për vendimet e këshillave të veta në rastet e caktuara me ligj;
- Vendos në shkallën e tretë dhe të fundit për ankesat kundër vendimeve të gjyqeve të apelit dhe vendimeve të këshillave të veta të marra në shkallën e dytë në raste të caktuara me ligj;
- Vendos për medikamente të jashtëzakonshme ligjore kundër vendimeve të plotfuqishme të gjyqeve dhe vendimeve të këshillave të veta në raste të caktuara me ligj; dhe
- Vendos për konfliktin mes kompetencave ndërmjet gjyqeve themelore nga rajone të ndryshme të gjyqeve të apelit, gjyqeve të apelit dhe gjyqeve themelore, dhe të vendos për bartjen e kompetencës vendore të këto gjyqe.

Fushëveprimi i çështjeve për të cilat Gjyqi suprem vendos në seancë të përgjithshme është me sa vijon:

- përcakton qëndrime parimore dhe mendime opinione parimore për çështje me rëndësi për sigurimin e unitetit në implementimin e ligjeve nga ana e gjyqeve;
- jep mendime për propozim të ligjeve dhe dispozitave të tjera në raste kur me ato rregullohen çështje të cilat janë të rëndësishme për punën e gjyqeve;
- shqyrton çështje në lidhje me punën e gjyqeve, implementimin e ligjeve dhe praktikës gjyqësore;
- sjell rregullore për punën e gjyqeve
- sjell program për punën e gjyqeve;
- përcakton mendim për zgjedhjen dhe ekzistimin e arsyeve për shkarkim të gjykatësit;
- vendos në bazë të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër vendimeve të këshillave të veta;
- e shqyrton raportin për punën e vet dhe raportet për punën e gjyqeve tjera.

Kompetencat e gjyqeve të apelit

Gjyqet e apelit janë gjyqe të shkallës së dytë. Ata janë kompetentë të vendosin për ankesat kundër vendimeve të gjyqeve themelore. Përpos kësaj kompetence, gjyqet e apelit janë kompetentë të vendosin edhe në raste kur ka konflikt të kompetencave mes gjyqeve themelore nga rajoni i tyre dhe të kryejnë punë tjera të përcaktuara me ligj.

Kompetenca e gjyqeve themelore

Të gjithë gjyqet themelore janë të shkallës së parë dhe ato janë kompetent të:

- Vendosin në shkallën e parë për lëndë nga kompetenca gjyqësore për punë penale, qytetare, jashtë procesit;
- Ekzekutojnë dhe sigurojnë, verifikojnë tapitë dhe intabulacionet; kundërvajtjet (në qoftë se nuk është përcaktuar me ligj që për lloje të caktuara të kundërvajtjeve të vendosin organe tjera - doganore, devizore, të tregtisë së jashtme, tatimore).

Gjashtëmbëdhjetë gjyqe themelore përpos kompetencave të lartpërmendura, për rajonet për të cilat janë të themeluara, në bazë të nenit 32 nga Ligji për gjyqet, janë kompetent edhe:

- të gjykojnë në shkallë e parë dhe kryerje të punëve në procedurën penale për vepra penale për të cilat është caktuar dënim burg mbi dhjet vite; dhe
- të vendosin për kundërvajtje ekonomike, konteste pronësore dhe konteste tjera të së drejtës qytetare në të cilat si palë paraqiten komunat, qyteti i Shkupit dhe Republika, ndërmarrjet dhe persona të tjerë fizikë, pronarë të dyqaneve dhe individë të tjerë të cilët kryejnë veprimtari ekonomike të regjistruar, konteste të personave juridikë nga vendi dhe personave të huaj fizikë, si dhe ndërmjet personave të huaj fizikë dhe juridikë,
- procedura për falimentim, shlyerja e dhunshme e detyrimeve dhe likuidimet dhe kontestet të cilat do të lindin më pas, konteste për ndryshime statutores (ndarje, bashkim, bashkëngjitje dhe orga-

nizim) dhe zbatimi i vendimeve të atyre gjyqeve,

- vendos për ligjshmërinë e aktit individual në kontestet administrative dhe të kontabilitetit,
- për mbrojtje kundër veprimeve joligjore, për miratimin dhe lejimin e zbatimit të vendimeve të huaja si dhe zbatimin e çështjeve tjera lidhur me të drejtën ndërkombëtare vetëm nëse me ligj ajo kompetencë nuk i takon ndonjë organi tjetër.

Prokuroria publike

Prokuroria publike është organ shtetëror i vetëm dhe i pavarur i cili i persekuton kryerësit e veprave penale të veprave të tjera penale të caktuara me ligj dhe kryen edhe punë të tjera të caktuara me ligj.

Prokuroria publike i kryen punët e saj në bazë të Kushtetutës dhe në kuadër të saj.

2.2.3 Avokati i popullit

Në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë është paraparë edhe institucioni Avokati i Popullit, i njohur në botë si Ombudsman. Në bazë të nenit 77 të Kushtetutës është paraparë që Kuvendi i Republikës së Maqedonisë të zgjedh Avokat popullor me kompetenca për t'i mbrojtur të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve në rastin kur ato do të jenë të shkelura nga organet e administratës shtetërore dhe organe tjera si dhe organizata të cilat kanë kompetenca publike.

Në bazë të ligjit për Avokat Popullor, Avokati i Popullit është i definuar si organ i cili i mbron të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve të cilat janë të shkelura nga organet e administratës shtetërore dhe organe dhe organizata të tjera të cilat kanë kompetenca publike, i cili i kushton kujdes të veçantë mbrojtjes së parimit të mosdiskriminimit, përfaqësimit të drejtë dhe adekuat të bashkësive etnike në organet e pushtetit shtetëror, organet e njësisë të vetëqeverisjes

lokale dhe në institucionet dhe shërbimet publike.

Këtë kompetencë, në pajtim me parimet nga neni 29 të Ligjit për Avokatin Popullor, mund ta zbatojë duke bërë përpos tjerave edhe vizita dhe inspektim në organet e administratës shtetërore dhe organe tjera dhe organizata të cilat kanë kompetenca publike si dhe në organet e pushtetit shtetëror, organet e njësisë të pushtetit lokal dhe institucionet dhe shërbimet shtetërore.

Në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve, Avokati i Popullit përpos që i mbron të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve kur ato janë të shkelura nga organet e administratës shtetërore dhe organe dhe organizata tjera të cilat kanë kompetenca publike vepron me peticion, në mes tjerash për pjesëtarët e bashkësive tjera të cilëve u janë të shkurtuara disa të drejta speciale të garantuara me Kushtetutë dhe me ligjet e Republikës së Maqedonisë. Kjo do të thotë se Avokati Popullor vepron edhe në raste kur ato janë të mendimit se u është bërë dëm gjatë shprehjes së kombësisë dhe religjionit, shkelje e të drejtave në lidhje me përdorimin e gjuhëve dhe shkrimit përpara organeve të administratës shtetërore dhe prej organeve të vetëqeverisjes lokale, cenimi i të drejtave në sferën e arsimit (fillor, të mesëm dhe të lartë), thyerja e të drejtave gjatë procesit votues, shkelja e të drejtave gjatë kryerjes së regjistrimit të popullatës në Republikën e Maqedonisë, shkelja e të drejtave gjatë intervenimeve policore (marrja e nënshtetësisë, marrja e letër njoftimit, marrja e pasaportës dhe vizave, tejkalimi i kompetencave nga ana e nëpunësve shtetëror), diskriminimi, trajtimi jo i drejtë dhe nënçmimi për shkak se i takon cilit do qoftë komunitet) dhe shkelje tjera të të drejtave.

Sipas ligjit, Avokati Popullor është i pavarur, autonom, profesional dhe efikas në zbatimin e funksionit.

Avokati Popullor në procedurën për hetim të thënieve në denoncimin ose në procedurën që e ka filluar me iniciativën e vet, është i obliguar që ti mblledh të gjitha faktet

dhe dëshmitë të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit gjatë procesit. Me qëllim të zbatimit të suksesshëm të kësaj përgjegjësie në nenin 27 të Ligjit për Avokatin Popullor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 60/03) është cekur se organet e administratës shtetërore, organet tjera dhe organizatat që kanë kompetenca publike, organet e njësive të pushtetit lokal ose shërbimet janë të detyruara të bashkëpunojnë me Avokatin Popullor dhe me kërkesë të tij t'ia sigurojnë të gjitha dëshmitë, të dhënat dhe informatat, pa dallim të shkalës së fshehtësisë dhe t'ia sigurojnë zbatim të procedurës. Nga ana tjetër, Avokati i Popullit është i obliguar ta ruajë sekretin shtetëror dhe zyrtar në mënyrë dhe me kushte të caktuara me ligj dhe normative tjera.

Avokati Popullor ka të drejtë të kërkojë shtyrje të përkohshme të zbatimit të ndonjë akti administrativ deri në marrjen e vendimit nga ana e organit të shkallës së dytë dhe shtyrje të zbatimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit nga ana e gjyqit kompetent,

nëse vlerëson se zbatimi i aktit administrativ do të shkaktojë dëm të pazëvendësueshëm për të drejtën e personit të interesuar. Neni 33 nga Ligji për Avokatin Popullor.

Një nga kompetencat më të rëndësishme të Avokatit Popullor është edhe kompetenca e nenit 30 nga Ligji për Avokatin Popullor në bazë të të cilit Avokati Popullor mund të jep propozim deri te Gjyqi Kushtetues i Republikës së Maqedonisë për vlerësimin e kushtetutshmërisë të ligjeve dhe kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së akteve dhe normave tjera.

Ligji për Avokatin Popullor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 60/03) i cili hyri në fuqi me datë 01.10.2003, me qëllim të zbatimit më të suksesshëm të kompetencave të Avokatit Popullor, në nenin 44 parashihet hapja e gjashtë zyrave të reja të Avokatit Popullor, të organizuara si njësi lokale. Me ligj është caktuar se zyra të këtylla do të hapen në qytetet Tetovë, Kërçovë, Shtip, Strumicë, Kumanovë dhe Manastir.



„Të Drejtat Zhvillimore të Mijëvjeçarit” - të ndërlidhura me Objektivat zhvillimore të mijëvjeçarit, rekomandime për zvogëlimin e varfërisë dhe të drejtat e njeriut

1. Objektivi zhvillimor i mijëvjeçarit 1: Të zvogëlohet varfëria dhe mos përfshirja sociale - të drejtat e njeriut për standard adekuat jetësor, për punë dhe për siguri sociale

1.1 Korniza ligjore ndërkombëtare

E DREJTA E STANDARDIT ADEKUAT JETËSOR

- **Pakti për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore i KB-ve, viti 1996**

- E drejta e standardit jetësor adekuat për personin dhe familjen e tij, duke përfshirë ushqimin adekuat, veshmbathjen, shtëpinë dhe e drejta e përmirësimit të vazhdueshëm të kushteve jetësore- Neni 11/1

- **Konventa e KB-ve për të drejtat e fëmijës, viti 1989.**

- E drejta e çdo fëmije për standard adekuat jetësor, për zhvillimin fizik, mental, shpirtëror, moral dhe social - Neni 27/1
- Përgjegjësia primare e çdo prindi/kujdestari, në kuadër të mundësive dhe kapacitetit financiar të sigurojë kushte për jetesë të domosdoshme për zhvillimin e fëmijës- Neni 27/2
- Shteti t’u ndihmojë prindërve/kujdestarëve dhe në raste urgjente, të sigurojë ndihmë materiale dhe programe për përkrahje posaçërisht për ushqim, veshmbathje dhe shtëpi- Neni 27/3
- Shteti të sigurojë kthim të alimentionit për fëmijën nga ana e prindërve/

persona tjerë me obligim financiar ndaj fëmijës - Neni 27/4

- E drejta e shëndetit, duke përfshirë edhe qasjen tek ushqimi kualitativ dhe uji i pastër për pije- Neni 24
- E drejta e fëmijës për pushim dhe kohë të lirë, lojë dhe rekreacion, pjesëmarrje në jetën kulturore dhe artistike - neni 31
- Fëmija me hendikep duhet të ketë një jetë të plotësuar dhe të denjë, dhe integrim sa më të kompletuar social, qasje të plotë të shërbimet dhe përkrahja shtetërore- Neni 23
- Mbrojtja e fëmijës nga çdo lloj dhune, gjithashtu dhe neglizhenca dhe eksploatimi - Neni 19
- Shteti të promovojë rehabilitim të fëmijës - viktimë e neglizhencës dhe eksploatimit- Neni 39

- **Konventa e KB-ve për eliminim e të gjitha llojeve të diskriminimit të gruas, viti 1979**

- Mosdiskriminimi i gruas në vendet rurale në aspekt të kushteve adekuate jetësore, posaçërisht në lidhje me banimin, higjienën, rrymën dhe furnizimin me ujë, transport dhe lidhje - Neni 14/2

E DREJTA PËR USHQIM DHE UJË

- **Pakti i KB-ve për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore - viti 1966**
 - E drejta e standardit adekuat jetësor për personin dhe familjen e tij, duke përfshirë edhe të ushqyerit adekuat - Neni 11/1
 - E drejta e çdokujt të mos ketë uri, duke përfshirë edhe prodhimin, konservimin, distribuimin e ushqimit me ndihmën e njohurive teknike dhe shkencore, duke përfshirë informata për parime adekuate ushqyese dhe përkrahje të reformave në sistemin agrar - Neni 11/2
 - Shteti duhet të ndërmarrë masa për sigurimin e shpërndarjes të drejtë të rezervave botërore të ushqimit - Neni 11/2
- **Konventa e KB-ve për të drejtat e fëmijës, viti 1989**
 - Përgjegjësia primare e prindërve/kujdestarëve tjerë të fëmijës, është që në kuadër të mundësive dhe kapacitetit të tyre financiar, të sigurojnë kushte të nevojshme për jetën e fëmijëve- Neni 27/2
 - Shteti t'u ndihmojë prindërve/kujdestarëve të fëmijës, dhe në raste urgjente të sigurojë ndihmë materiale dhe programe për përkrahje, posaçërisht lidhur me të ushqyerit, veshmbathjen dhe banimin - Neni 27/3
 - E drejta e shëndetit, duke përfshirë edhe qasjen deri te ushqimi i shëndetshëm dhe uji i pastër për pije - Neni 24
- **Konventa e KB-ve për eliminim e të gjitha llojeve të diskriminimit të gruas, viti 1979**
 - Mosdiskriminimi i gruas në vendet rurale në lidhje me tokën dhe reformën agrare si dhe në skemat për banim të sërishëm të vendit - Neni 14/2

- Mosdiskriminimi i gruas në vendet rurale në lidhje me kushtet adekuate jetësore, posaçërisht lidhur me banimin, higjienën, rrymën dhe furnizim e ujit, transportit dhe lidhjeve - Neni 14/2

E DREJTA E BANIMIT

- **Pakti i KB-ve për të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore - viti 1966**
 - E drejta e standardit adekuat jetësor për personin dhe familjen e tij, duke përfshirë edhe strehimin adekuat- Neni 11/1
- **Konventa e KB-ve për të drejtat e fëmijës, viti 1989**
 - Përgjegjësia primare e prindërve/kujdestarëve për fëmijën është që të sigurojnë, në kuadër të mundësive dhe kapacitetit financiar, kushte të nevojshme për jetesën e fëmijëve - Neni 27/2
 - Shteti t'u ndihmojë prindërve/kujdestarëve të fëmijës dhe në raste urgjente të sigurojë ndihmë materiale dhe programe për përkrahje, posaçërisht lidhur me ushqimin, veshmbathje dhe banimin - Neni 27/3
 - Është e ndaluar përzjerja arbitrare ose e paligjshme në privatësinë dhe shtëpinë e fëmijës - neni 16
- **Konventa e KB-ve për eliminim e të gjitha llojeve të diskriminimit të gruas, viti 1979**
 - Mosdiskriminimi i gruas në vendet rurale në lidhje me kushtet adekuate jetësore, posaçërisht lidhur me banimin, higjienën, rrymën dhe furnizimin e ujit, transport dhe lidhje - Neni 14/2
- **Konventa e KB-ve për eliminim e të gjitha formave të diskriminimit racor, viti 1965**
 - Eliminimi i diskriminimit të grupeve etnike lidhur me të drejtën e banimit - Neni 5

E DREJTA E PARAQITJES NË PUBLIK PA KURRFARË TURPI

• Pakti i KB-ve për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore i KB - viti 1966

- E drejta e standardit adekuat jetësor për personin dhe familjen e tij duke përfshirë edhe veshmbathjen adekuate por gjithashtu edhe përparimin e kushteve jetësore - Neni 11/1
- E drejta e pjesëmarrjes në jetën kulturore- Neni 15/1

• Pakti ndërkombëtar për të drejtat politike dhe qytetare, viti 1966

- Ndalim i torturës ose tjetër lloj sjellje johumane dhe degraduese ose dënim -Neni 7
- Personi i privuar nga liria të trajtohet me njerëzi dhe respekt për dinjitetin inherent të njeriut-Neni 10/1
- është e ndaluar interferenca joligjore dhe arbitrare në privatësinë e personit dhe familjes së tij, shtëpisë ose korrespondencës: dhe mbrojtje ligjore kundër interferencës - neni 17

• Konventa e KB-ve për të drejtat e fëmijës, viti 1989

- E drejta e fëmijës për jetë, mbijetesë dhe zhvillim - Neni 6
- E drejta e çdo fëmije për standard adekuat njerëzor gjatë zhvillimit fizik, mental, shpirtëror, moral dhe social - Neni 27/1
- Përgjegjësia primare e prindërve/kujdestarëve të fëmijës është që të sigurojnë në kuadër të mundësive dhe kapacitetit financiar, kushte të nevojshme për zhvillimin e fëmijës - Neni 27/2
- Shteti t'u ndihmojë prindërve/kujdestarëve për fëmijën dhe në raste urgjente të sigurojë ndihmë materiale dhe programe për përkrahje, posaçërisht lidhur me ushqimin, veshmbathjen dhe banimin - Neni 27/3
- E drejta e fëmijës për pushim dhe kohë të lirë, lojë dhe rekreacion, pjesëmarrje në jetën kulturore dhe artistike - neni 31

- Është e ndaluar përzjerja arbitrare ose e paligjshme në privatësinë, familjen, shtëpinë dhe korrespondencën e fëmijës - neni 16

- Fëmija me handicap duhet të ketë një jetë të plotësuar dhe të denjë, integrim sa është e mundur më të kompletuar, qasje të plotë te shërbimet dhe përkrahje shtetërore- Neni 23

- Fëmija i privuar nga liria duhet të trajtohet me humanizëm dhe me respekt për dinjitetin inherent të njeriut, ndalimi i torturës ose ndonjë sjellje tjetër të ashpër, johumane dhe degraduese ose dënim -Neni 37

- Standarde për të drejtat e të miturve dhe alternativa për privimin nga liria - Neni40/4

• Konventa e KB-ve për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të gruas, viti 1979

- Mosdiskrimini i gruas në lidhje me të drejtën për të marrë pjesë në aktivitete rekreative, sportive dhe në të gjitha aspektet e jetës kulturore - Neni 13

• Konventa e KB-ve për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor, viti 1965

- Eliminimi i diskriminimit të grupeve etnike lidhur me të drejtën për pjesëmarrje të barabartë në aktivitetet kulturore - Neni 5
- Eliminimi i diskriminimit të grupeve etnike lidhur me të drejtën për qasje deri në çdo vend të dedikuar për shfrytëzim nga publiku i gjerë, siç është transporti, hotelet, restorantet, kafiteritë, teatrot dhe parqet - Neni 5

• Konventa kornizë e Këshillit të Evropës për mbrojtjen e pakicave etnike, viti 1995

- Shteti të krijojë kushte të domosdoshme për participim efektiv të pakicave etnike në jetën kulturore, sociale dhe ekonomike si dhe në punët publike - Neni 15

E DREJTA E PUNËS SË PËRSHTATSHME

- **Pakti ndërkombëtar i KB-ve për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore - viti 1966**
 - E drejta e punës, duke përfshirë edhe orientimin profesional dhe trajnimin - Neni 6
 - E drejta e kushteve korrekte dhe të përshtatshme, duke përfshirë edhe mëditjet korrekte dhe kompensim të barabartë për punën me vlerë të njëjtë, posaçërisht grave t'u garantojen kushte për punë të cilat nuk janë më të këqija nga ato të burrave, me rrogë të njëjtë për punë të njëjtë, kushte të sigurta dhe të shëndetshme, mundësi të njëjta për të gjithë në punën e tyre, të avancohen në shkallë më të lartë, pushim, kohë të lirë dhe limitim të arsyeshëm të kohës së punës dhe pushime të paguara periode - Neni 7
 - E drejta e përfshirjes në formimin dhe funksionimin e sindikatave dhe e drejta e grevës (konform standardeve të ILO-s) - Neni 8
 - Mbrojtje të veçantë të fëmijëve nga eksploatimi ekonomik dhe social - Neni 10
- **Pakti ndërkombëtar për të drejtat qytetare dhe politike, viti 1966**
 - Secili ka të drejtë të bashkohet me të tjerë, duke përfshirë edhe të drejtën e formimit dhe anëtarësimit në sindikata për mbrojtjen e interesave të tij - Neni 22
- **Konventa e KB-ve për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor, viti 1965**
 - Eliminimi i diskriminimit të disa grupeve etnike në lidhje me të drejtën e punës, duke përfshirë edhe zgjedhjen e lirë për punësim, mbrojtje nga papunësia, rrogë të barabartë për punë të barabartë dhe kompensim të volitshëm dhe të drejtë, si dhe kushte të volitshme dhe korrekte për punë - Neni 5
- **Konventa e KB-ve për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të graas, viti 1979**
 - Mosdiskriminimi i graas në sferën e punësimit/e drejta e punës, duke përfshirë edhe mundësitë e njëjta për punësim dhe zgjedhje të lirë të profesionit, kompensim të barabartë të punës për vlerë të barabartë, avancim në nivel më të lartë, trajnim profesional, kushte pune dhe masa mbrojtëse konkrete lidhur me amësinë - Neni 11
 - Mosdiskriminimi i graas sa i përket qasjes deri te huat bankare, hipotekat dhe format tjera të kredisë financiare - neni 13
 - Mosdiskriminimi i graas në vendet rurale lidhur me qasjen e njëjtë deri te mundësitë ekonomike përmes punësimit dhe vetëpunësimit, duke përfshirë edhe qasjen deri te kreditë bujqësore dhe huat, beneficione për marketing, teknologji të përshtatshme dhe trajtim të njëjtë te toka dhe reformat agrare si dhe në skemat për ribanim të tokës dhe organizimin e grupeve për vetëdihmë dhe kooperativa - Neni 14
 - Mosdiskriminimi i graas në marrëdhëniet familjare dhe qasja në tokë, lidhur me pronësinë, blerjen, menaxhimin, udhëheqjen, posedimi dhe dispozicioni i pronës - Neni 16
- **Konventa e KB-ve për të drejtat e fëmijës, viti 1989**
 - E drejta e fëmijës për mbrojtjen nga eksploatimi ekonomik dhe nga kryerja e çfarëdo pune me gjasa për të qenë e ose të ndërlidhet me arsimimin e fëmijës ose të jetë e dëmshme për shëndetin e fëmijës dhe për zhvillimin e tij fizik, mental, shpirtëror, moral dhe social - Neni 32/1
 - Shteti duhet të parashohë moshë minimale për punësim, rregullimin e orarit të punës dhe kushtet në punë (lidhur me standardet ndërkombëtare, duke përfshirë edhe ILO) - Neni 32/2

- **Akti Sociale Evropian i Këshillit të Evropës, viti 1961**

((lidhur me premtimet të deklaruara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë në bazë të nenit 20 nga Akti Social Evropian))

- E drejta e përfitimit për jetesë në një profesion të zgjedhur lirshëm, shteti duhet të anojë kah një shkallë më e lartë dhe më stabile të punësimit, me qëllim që të arrihet punësim i plotë, të ketë shërbime pa pagesë për punësim, të promovojë orientim profesional dhe trajnime - Neni 1
- E drejta e kushteve korrekte në punë, duke përfshirë edhe dispozitat për orar të arsyeshëm pune, pauzë dhe pushime të paguara- Neni 2
- E drejta e organizimit dhe negociemeve kolektive- Nenet 5 dhe 6
- E drejta e fëmijës për mbrojtje nga eksploatimi ekonomik, duke përfshirë edhe përcaktimin e moshës minimale për punësim, orari i punës, kontrolli mjekësor, trajnimi profesional, ndërprerja e punës gjatë natës - Neni 7 (me përjashtim të paragrafit 5, nuk është i miratuar në Maqedoni)
- Të drejtat për mbrojtje të grave të punësuar, përfshirë këtu edhe dispozitat për pushim para/pas lindjes, përkujdesje të foshnjës, ndalimi i disa formave specifike të punës - Neni 8
- E drejta për trajnim profesional, reabilitim dhe reintegrim social të personave me handicap psikik dhe fizik - Neni 15

E DREJTA E SIGURISË SOCIALE DHE NDIHMËS SOCIALE

- **Pakti i KB-ve për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore i KB, viti 1966**
 - E drejta e sigurisë sociale, duke e përfshirë edhe sigurimin social - Neni 9
- **Konventa e KB-ve për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor, viti 1965**
 - Eliminimi i diskriminimit të grupeve të caktuara lidhur me të drejtën e sig-

urisë sociale dhe shërbimeve sociale - Neni 5

- **Konventa e KB-ve për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të gruas, viti 1979**

- Mosdiskriminim i gruas në lidhje me të drejtën për siguri sociale dhe qasje deri te beneficionet familjare - Neni 11 dhe 13
- Mosdiskriminim i gruas në vendet rurale lidhur me shfrytëzimin direkt nga programet e sigurisë sociale- Neni 14

- **Konventa e KB-ve për të drejtat e fëmijës, viti 1989.**

- E drejta e fëmijës të shfrytëzojë siguri sociale, përfshirë këtu edhe sigurimin social - Neni 26

- **Konventa Evropiane Sociale e Këshillit të Evropës, viti 1961.**

(në bazë të angazhimeve të deklaruara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë sipas nenit 20 të Kartës Sociale Evropiane)

- E drejta e sigurisë sociale dhe shteti duhet në mënyrë progresive t'i ngrit standardet e sigurisë sociale (lidhur me standardet e ILO) - Neni 12
- E drejta e ndihmës sociale dhe mjekësore, duke e përfshirë edhe qasjen deri te këshillat dhe informatat - Neni 13

MBROJTJA E TË DREJTAVE TË FËMIJËS SI KUJDES PRIMAR

- **Konventa e KB-ve për të drejtat e fëmijës e KB, viti 1989**

- Interesat më të mira të fëmijës si kujdes primar në të gjitha veprimet të cilat i përkasin fëmijës, vlerësim i efektit mbi fëmijët dhe ndjenja e fëmijëve- Nenet 3/1 dhe 12

MOSDISKRIMINIMI I GRUAS DHE AKSIONI AFIRMATIV

- **Konventa e KB-ve për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të gruas, viti 1979**
 - Shteti me të gjitha pajisjet e përshatshme dhe pa asnjë vonesë duhet

të ndjekë një politikë të eliminimit të diskriminimit të gruas, duke përfshirë edhe legjislativën, sanksionet dhe mbrojtjen ligjore për gratë dhe të sigurojë zhvillim të plotë dhe përparim të femrave, duke përfshirë edhe sferën ekonomike edhe atë sociale, dhe të miratoj masa të përkohshme speciale të cilat kanë për qëllim ta përshpejtojnë barazinë faktike në mes femrave dhe meshkujve - Nenet 2 deri 4

MOSDISKRIMINIMI I GRUPEVE ETNIKE DHE AKSIONI AFIRMATIV

- **Konventa kornizë për mbrojtjen e pakicave etnike e Këshillit të Evropës, viti 1995**
 - Barazi të plotë dhe efektive në mes pakicave etnike dhe shumicës, duke përfshirë të gjitha sferat e jetës ekonomike dhe sociale- Neni 4/2

Propozim rekomandime të KB-ve për qasje në të drejtat e njeriut lidhur me strategjitë për uljen e varfërisë 2002

Rekomandimi 6: E drejta e ushqimit adekuat

- **Qëllimi 1:** Të gjithë njerëzit duhet të jenë të liruar nga uria kronike
- **Qëllimi 2:** Eliminimi i pabarazisë gjinore në qasjen e ushqimit
- **Qëllimi 3:** Të gjithë njerëzit duhet të jenë të liruar nga pasiguria në ushqim
- **Qëllimi 4:** Të gjithë njerëzit duhet të kenë qasje deri te ushqimi me vlerë të përshtatshme ushqyese
- **Qëllimi 5:** Të gjithë njerëzit të kenë qasje deri te ushqimi i sigurt

Direktiva 9: E drejta e punës

- **Qëllimi 1:** Punësim të plotë
- **Qëllimi 2:** Të gjithë punëtorët të mundën të fitojnë minimumin e të ardhura të nevojshme
- **Qëllimi 3:** Të gjithë të punësuarit të pranojnë ndihmë të arsyeshme financiare në periudhën e papunësisë
- **Qëllimi 4:** Të eliminohet pabarazia mes gjinive në qasjen drejt punës
- **Qëllimi 5:** Të eliminohet pabarazia mes gjinive lidhur me rrogat
- **Qëllimi 6:** Të eliminohet punësimi i fëmijëve
- **Qëllimi 7:** Të eliminohet punësimi edukativ

Rekomandimi 10: E drejta e banimit të përshtatshëm

- **Qëllimi 1:** Të gjithë njerëzit të kenë shtëpi
- **Qëllimi 2:** Të gjithë njerëzit të kenë siguri lidhur me pronën
- **Qëllimi 3:** Të gjithë njerëzit të kenë banim të përshtatshëm
- **Qëllimi 4:** Të gjithë njerëzit duhet të kenë banim të vendosur në një rreth të sigurt dhe të shëndoshë
- **Qëllimi 5:** Të gjithë njerëzit të kenë mundësi që t'i lejojnë vetes një banim adekuat
- **Qëllimi 6:** Banim adekuat të arritshëm fizikisht për çdo kënd
- **Qëllimi 7:** Të gjithë njerëzit të kenë banim me qasje deri te shërbimet, materialet, pajisjet dhe infrastrukturën themelore.

Rekomandimi 12: E drejta e paraqitjes në publik pa turp

- **Qëllimi 1:** Mundësia e të varfërve të paraqiten në publik pa kurrfarë far turpi

1.2 Korniza ligjore për të drejtat e njeriut në Maqedoni

1.2.1 Të drejtat e njeriut për standard adekuat jetësor, punë dhe siguri sociale

1.2.2 Prezantim

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë e vitit 1991

Neni 30

Garantohen e drejta e pronësisë së pasurisë dhe e drejta e trashëgimisë. Pronësia e pasurisë krijon të drejta dhe obligime dhe duhet të jetë në shërbim të së mirës së personit por edhe të komunitetit. Askujt nuk mund t'i merret prona e tij ose të drejtat që dalin nga ajo, vetëm në raste të interesit publik të përcaktuara me ligj. Nëse prona merret ose limitohet, garantohehet kompensim i drejtë i cili nuk është më i ulët nga vlera e tij në treg.

Neni 32

Secili ka të drejtë në punë, në zgjedhje të lirë të punësimit, mbrojtje në punë dhe ndihmë materiale për papunësi të përkohshme. Secili vend pune është i hapur nën kushte të njëjta. Secili i punësuar ka të drejtë kompensimi të caktuar. Secili i punësuar ka të drejtë pushimi të paguar ditor, javor dhe vjetor. Të punësuarit nuk guxojnë të heqin dorë nga kjo e drejtë. Krahasimet e të drejtave të punonjësve dhe vendeve të tyre të punës janë të rregulluara me ligj dhe me marrëveshje kolektive

Neni 34

Qytetarët kanë të drejtën e sigurisë sociale dhe sigurimit social, të rregulluara me ligj dhe me marrëveshje kolektive.

Neni 35

Republika parasheh mbrojtje sociale dhe siguri sociale të qytetarëve në pajtim me parimin për të drejtën sociale. Republika ua garanton të drejtën e ndihmës qytetarëve të cilat janë të pafuqishëm ose të paafte për punë. Republika siguron mbrojtje të veçantë për personat me handicap, si dhe kushte për përfshirjen e tyre në jetën shoqërore.

Neni 37

Që t'i zbatojnë të drejtat e tyre ekonomike dhe sociale, qytetarët kanë të drejtë të formojnë sindikate. Sindikatat mund të paraqesin lidhje/unione dhe të anëtarësohen në organizatat sindikale ndërkombëtare. Ligji mund të kufizojë kushtet për zbatimin e së drejtës për organizim sindikal në forcat e armatosura, polici dhe organet e administratës.

Neni 38

E drejta e grevës është e garantuar. Ligji mund t'i kufizojë kushtet për organizimin e së drejtës së grevës në forcat e armatosura, polici dhe organet administrative.

1.2.3 E drejta e punës

E drejta e punësimit

Marrëdhënia e punës është marrëdhënie e kontraktuar në mes të punësuarit dhe punëdhënësit, përmes së cilës i punësuarit me vetëdëshirë hyn në proces të organizuar të punës në organizatën e punëdhënësit, për rrogë ose për të ardhura tjera, dhe per-

sonalisht dhe vazhdimisht kryen punë në pajtim me instruksionet dhe në mbikëqyrje të punëdhënësit.

Ndalimi i diskriminimit

Punëdhënësi nuk mund ta vejë atë që kërkon punë ose punëtorin, në pozitë të pabarabartë në bazë të racës, ngjyrës së

lëkurës, gjinisë, moshës, gjendjes shëndetësore (invaliditetit), religjionit, politikës ose çfarë do qoftë bindjeje, anëtarësimi në sindikate, prejardhje etnike dhe sociale, statusi familjar, statusi financiar, orientimi seksual dhe çfarë do qoftë gjëje tjetër personale.

Diskriminim direkt është çfarë do qoftë veprim i kushtëzuar në bazat e lartpërmendura, me të cilat personi është vënë ose mund të vihet në pozitë të palakueshme krahasuar me pozitën e personave tjerë në raste të njëjta. Diskriminim indirekt, në kuptim të këtij ligji, ekziston kur ndonjë dispozitë neutrale, kriter dhe praktikë e ven ose do ta vejë personin që kërkon punë ose të punësuarin në pozitë jo të përshtatshme nga personat tjerë, në bazë të ndonjë karakteristike të caktuar, statusi, lidhshmërie dhe bindjeje.

E drejta e kontratës për punësim

Punëdhënësi është i obliguar ta paraqet të punësuarin në skemën e obligueshme për siguri sociale (sigurim pensional dhe invalidor dhe sigurim gjatë papunësisë) në pajtueshmëri me norma të veçanta. Kopje e verifikuar nga paraqitja duhet t'i jepet të punësuarit në afat prej tri ditësh pas fillimit të punësimit.

Të punësuarit nuk guxojnë të fillojnë me punë përpara se të nënshkruajnë kontratë për punësim dhe përpara se të jenë paraqitur në sigurimin e obligueshëm social.

Kontrata për punësim mund të bëhet nga ana e personave të cilët kanë mbushur 15 vjeç dhe kanë mundësi të përgjithshme shëndetësore.

Secila kontratë për punësim, në të cilën merr pjesë person më i ri se 15 vjet, konsiderohet si i pavlefshme.

E drejta për mëditje

Pagesa për punën në bazë të kontratës për punësim çdo herë duhet të jetë në formë të parave. Gjatë pagesës, punëdhënësit janë të obliguar të paguajnë së paku shumën

minimale që është e definuar në kontratën kolektive, në pajtim me ligjin, i cili në mënyrë direkte e obligon punëdhënësin. Rroga përbëhet nga rroga themelore, pjesa për punë të suksesshme dhe shtesa. Rroga themelore caktohet duke i marrë parasysht kushtet e vendit të punës për të cilin i punësuarit ka nënshkruar kontratë për punësim. Suksesi i punës të së punësuarit, caktohet duke marrë parasysht përgjegjësinë, kualitetin dhe sferën e përgjegjësisë të vendit të punës për të cilin i punësuarit ka nënshkruar kontratë për punësim. Shtesat paguhet për kushte të veçanta pune, që ndërlidhen me orarin e punës, në kuptim të punës në turne, punë me orar pune të ndarë, turni i natës, orari i zgjatur i punës, punë gjatë uikendeve dhe gjatë festave të caktuara me ligj, dhe shtesa për përvojë pune.

Rrogat duhet të paguhet jo më vonë se 15 ditë pas mbarimit të periudhës për pagesë.

Punëdhënësit duhet në fillim në formë të shkruar t'i njoftojnë të punësuarit për datën e pagesës dhe për çfarë do qoftë ndryshime në datën e pagesës. Punëdhënësit duhet (gjithmonë kur bëhet pagesa e rrogave dhe deri më 31 janar të vitit kalendarik) t'i sigurojnë të punësuarit deklaratë të shkruar për rrogën dhe beneficionet e rrogës për periudhën e paguar ose për vitin e fundit, e cila gjithashtu i tregon edhe kalkulimet dhe pagesat e taksave dhe beneficioneve.

Të gjitha shpenzimet lidhur me pagesën e rrogave, duhet t'i bart punëdhënësi.

Të drejtat e punëtorëve kundrejt punëdhënësit

Të punësuarit të cilëve punëdhënësi nuk ua ka paguar rrogat dhe beneficionet për tre muaj me radhë, kanë të drejtë të fillojnë procedurë për likuidim të punëdhënësit. Të punësuarit të cilëve marrëdhëniet punuese u janë ndërprerë për shkak të procedurës së likuidimit të punëdhënësit, kanë të drejtë (në pajtim me ligjin) për pagesë të:

- Rrogave dhe beneficioneve për sigurim pensional dhe invalidor për periudhën e tre muajve të fundit përpara se të fillojë procedura e likuidimit të punëdhënësit;
- Kompensim për lëndime në punë të cilat i ka pasur i punësuar dhe për çfarë do qoftë sëmundje profesionale, dhe
- Çfarë do qoftë tatime të papaguara të rrogës për zgjatjen e pushimit të rregullt vjetor të pashfrytëzuar në vitin vijues kalendarik

Kompensimi i shpenzimeve që kanë të bëjnë me vendin e punës

Të punësuarit kanë të drejtë kompensimi të shpenzimeve lidhur me vendin e punës për:

- ushqim gjatë orarit të punës, nëse paguhen me parà;
- udhëtime zyrtare;
- punë në terren;
- shfrytëzimin e veturës private për udhëtime zyrtare;
- jetë të ndarë nga familja; dhe
- vdekjen e të punësuarit ose anëtarit të familjes së tij

E drejta e orarit të shkurtuar të punës

Orari i plotë i punës nuk mund të tejkalojë 40 orë në javë. Punëdhënësi me 25 të punësuar dhe proces pune që kryhet në një lokacion, duhet të mbaje evidencë elektronike për orarin e plotë të punës dhe për çfarë do qoftë pune pas orarit të punës. Puna pas orarit të punës nuk mund të tejkalojë 10 orë gjatë një jave dhe mbi 190 orë gjatë vitit.

E drejta e pauzave dhe pushimeve

Në orarin e punës gjatë ditës, të punësuarit me orar të plotë pune kanë të drejtë të kenë pauzë me kohëzgjatje prej 30 min. Koha për pauzë gjatë ditës së punës konsiderohet si orar pune dhe paguhet në pajtim me të.

Të punësuarit kanë të drejtë të kenë pauzë ndërmjet dy ditëve të njëpasnjëshme të punës, me kohëzgjatje në kontinuitet jo më pak se 12 orë. Të punësuarit kanë të drejtë të kenë pushim javor prej më së paku 24 orëve të pandërprera. Të punësuarit kanë të drejtë të kenë pushim vjetor me kohëzgjatje prej 20 deri 26 ditë. Pas mbarimit të punësimit, të punësuarit kanë të drejtë të marrin kompensim për pjesën e pashfrytëzuar të pushimit vjetor.

Secila kontratë në bazë të së cilës punësimi e anulon të drejtën e pushimit vjetor ose kompensimin për pushimin vjetor, konsiderohet si e pavlefshme.

E drejta e formimit të sindikatave

Të punësuarit kanë të drejtë të formojnë sindikate në bazë të vullnetit të lirë dhe të bëhen anëtarë të saj, në bazë të kushteve të vendosura me rregulloren e asaj sindikate. Të punësuarit vetë vendosin për anëtarësimin te ajo sindikatë ose për heqje dorë nga sindikata. Sindikata është një organizatë punëtorësh e cila është e pavarur, demokratike dhe autonome kah e cila punëtorët kyçen me vullnet të lirë me qëllim të përfaqësimit, mbrojtjes dhe përmirësimit të drejtave të tyre ekonomike, sociale dhe të drejta tjera individuale dhe kolektive.

Askush nuk guxon të vihet në pozitë të keqe për shkak të anëtarësimit ose për shkak se nuk është anëtar i sindikatës, ose për shkak të pjesëmarrjes ose jo pjesëmarrjes në punën e sindikatës.

E drejta e grevës

Sindikata dhe shoqatat e saja në një nivel më të lartë kanë të drejtë të thirrën në grevë dhe ta udhëheqin atë, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave ekonomike dhe sociale të anëtarëve të saj, në pajtueshmëri me ligjin.

Greva duhet të paralajmërohet në formë të shkruar deri te punëdhënësi ose deri te shoqata e punëdhënësve kundër të cilëve

organizohet, ndërsa grevat e solidaritetit duhet të paralajmërohen te punëdhënësit në objektet e të cilëve organizohen.

Të punësuarit nuk guxojnë të vihen në pozitë të papërshtatshme në krahasim me të punësuarit e tjerë për shkak se kanë organizuar ose kanë marrë pjesë në greva të organizuara në pajtim me dispozitat ligjore ose të kontratës kolektive.

Disa të drejta sigurimi në rast papunësie - ndihma financiare: E drejta për ndihmë financiare është e rezervuar për persona të cilët kanë qenë të punësuar më së paku nëntë muaj pa ndërprerje ose 12 muaj me ndërprerje në 18 muajt e fundit. Të papunësuarit kanë të drejtë të marrin ndihmë financiare për kohën të cilën e kanë kaluar si të punësuar dhe për të cilën janë paguar kompensimet.

1.2.3 E drejta e pensionit- sigurimi invalidor

E drejta e pensionit

Personat e siguruar e fitojnë të drejtën e pensionit kur mbushin 64 vjeç (meshkujt) dhe 62 (femrat) dhe kanë më së paku 15 vite eksperiencë pune.

Shuma minimale e pensionit nga sigurimi i obligueshëm pensional-invalidor në bazë të solidaritetit të gjeneratës dhe pensioni nga kapitali i obligueshëm i financimit, sigurim pensional-invalidor, nuk duhet të jetë më e vogël se rroga mesatare e kalkuluar për të gjithë të punësuarit në Republikën e Maqedonisë në vitin 2000, edhe atë:

- Për shfrytëzuesit e pensionit të cilët e kanë fituar të drejtën e pensionit me më shumë se 35 vite eksperiencë pune (meshkujt) dhe më shumë se 30 vjet pune (femrat) në vlerë prej 41%
- Për shfrytëzuesit e pensionit të cilët e kanë fituar të drejtën e pensionit me më shumë se 25 vite eksperiencë pune (meshkujt) dhe më shumë se 20 vjet pune (femrat) në vlerë prej 38%, dhe
- Për shfrytëzuesit e pensionit të cilët e fituar të drejtën e pensionit me 25

vite eksperiencë pune (meshkujt) dhe me 20 vjet pune (femrat) në vlerë prej 38%.

E drejta e pensionit invalidor

Personat e siguruar të cilët e kanë humbur aftësinë punuese, si dhe personat e siguruar me aftësi të mbetur punuese, por për shkak të moshës së tyre nuk kanë aftësi të marrin ndonjë kualifikim tjetër ose kualifikim plotësues për t'u aftësuar përkryerjen e ndonjë pune tjetër, fitojnë të drejtën e pensionit invalidor, nën këto kushte:

- 1) invaliditeti të jetë shkaktuar nga lëndimi në punë ose nga sëmundja profesionale pavarësisht nga vitet e stazhit, dhe
- 2) invaliditeti të jetë shkaktuar jashtë punës ose nga sëmundja, me kusht palët të kenë numër të mjaftueshëm të viteve të stazhit të punës përpara shkaktimit të invaliditetit, dhe numri i viteve të stazhit të punës të mbulojë së paku një të tretën e periudhës që fillon nga dita kur kanë mbushur 20 vite deri në ditën kur është paraqitur invaliditeti ose deri te dita e skadimit të sigurimit pas paraqitjes së invaliditetit (vite stazhi), duke marrë parasysh vitet e plota të stazhit.

E drejta e pensionit familjar

Pension familjar mund të marrin këto anëtarë të familjes:

- bashkëshortori-ja
- fëmija (të lindura në martesë ose jashtë martesë, ose fëmija i adoptuar nga ana e personit të siguruar, nipër dhe fëmijë tjerë pa prindër të përkujdesur nga ana e personit të siguruar) dhe
- Prindër (baba dhe nënë, njerë dhe njerë) dhe prindërit-adoptuesit të përkujdesur na ana e personit të siguruar

Pension familjar mund të merr edhe bashkëshorti i divorcuar, me kusht që të ekzistojë vendim gjyqësor i cili i jep të drejtë për përkujdesje të këtyre.

1.2.4. Mbrojtja sociale

Mbrojtja sociale është veprim me interes publik dhe e organizon shtetin me qëllim që të ndalohen dhe tejkalohen rreziqet sociale themelore me të cilët ballafaqohen qytetarët, familjet dhe grupet e qytetarëve gjatë jetës së tyre. Rreziku social është: rreziku shëndetësor (sëmundje, lëndim dhe invaliditet), rreziku nga plakja (pleqëria dhe mirëmbajtja), amësia dhe rreziku familjar, rreziku nga papunësia paaftësia profesionale, dhe rreziku nga mosadaptimi në mjedisin shoqëror.

Komunat, qyteti i Shkupit, dhe komunat në qytetin e Shkupit organizojnë dhe e sigurojnë zbatimin e mbrojtjes sociale përmes përgatitjes së programeve zhvillimore të tyre për nevojat konkrete të qytetarëve në lëmin e mbrojtjes sociale si dhe akte të përgjithshme në lëmin e mbrojtjes sociale.

Komunat, qyteti i Shkupit, dhe komunat në qytetin e Shkupit mund ta sigurojnë zbatimin e mbrojtjes sociale të personave me pengesa fizike, fëmijë pa prindër dhe fëmijë pa mbrojtje prindërore, fëmijë me nevoja të veçanta, fëmijë nga rruga, fëmijë me probleme arsimore dhe sociale, fëmijë nga familjet me prindër vetushqyes, persona të nënshtruar në rrezikun social, persona të cilët keqpërdorin alkool dhe drogë dhe persona më të moshuar pa përkujdesje familjare në formë të mbrojtjes institucionale dhe jashtë institucionale, banim për personat e rrezikuar dhe ngritjen e vetëdijes te popullata për nevojën e sigurimit të mbrojtjes sociale.

Të drejtat e mbrojtjes sociale

- Ndhimë sociale e vazhdueshme: E drejta e ndihmës sociale në vazhdueshmëri është e drejta e personave të paaftë për punë, pa siguri sociale dhe ata të cilët nuk janë në pozitë të sigurojnë mjete personale për ekzistencë. Persona të paaftë për punë janë personat:

- me pengesa të lehta, mesatare dhe të rënda në zhvillimin psikik, persona me pengesa tjera në zhvillim të cilët (për shkak të natyrës së pengesave) nuk mund të fitojnë arsim si dhe persona të cilët kanë mbetur me handicap pas periudhës zhvillimore dhe si rezultat i së cilës nuk janë të aftë të punojnë;
- nëna të divorcuara gjatë shtatzënisë një muaj para lindjes dhe prindër të vetëm deri sa fëmija të mbush tre vjeç;
- fëmijët të moshës deri më 15 vjeç ose, nëse ndjekin arsim të rregullt deri më 26 vjeç dhe;
- femra dhe meshkuj më të moshuar se 65 vjeç.

Persona pa sigurim social janë ata persona të cilët nuk kanë të ardhura dhe të ardhurat e të cilëve në të gjitha aspektet (si të ardhura të gjithë familjes) janë më të ulëta nga ndihma e vazhdueshme financiare e përcaktuar me këtë ligj.

Fëmijë pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore janë ata të cilët nuk janë të mbrojtur në lidhje me të drejtën e banimit dhe ata të cilët nuk kanë të ardhura lidhur me pronën dhe të drejta të pronës të bazuara në çfarë do qoftë norma tjera, kanë të drejtë për ndihmë financiare të vazhdueshme vlera e së cilës do jetë e barabartë me vlerën e ndihmës financiare themelore deri në moshën 18 vjeç ose deri në kohën kur do të bëhen të aftë të jetojnë një jetë të pavarur, mirëpo në çdo rast jo më vonë se koha kur do mbushin 26 vite.

- **Shtesa sociale financiare për personat e aftë për punë dhe personat pa sigurim social:** Personat e aftë për punë por edhe personat pa sigurim social të cilët nuk mund të sigurojnë mjete për ekzistencë në bazë të të gjitha normave kanë të drejtë të marrin beneficione sociale
- **Shtesa financiare për ndihmë dhe përkujdesje:** e drejta e shtesave financiare për ndihmë dhe përkujdesje nga personi tjetër, është e drejta e person-

ave të cilët nuk janë të aftë t'i kënaqin nevojat themelore (të paaftë të lëvizin nëpër shtëpi edhe me mjete ndihmëse; të paaftë të mbajnë higjienë personale, të vishen, të marrin ushqim dhe të kryejnë funksione tjera për përmbushjen e nevojave themelore), gjegjësisht persona të cilët nuk janë të aftë të lëvizin, tërësisht të verbër, vuajnë nga distrofia ose sëmundje muskulore apo nervore-muskulore, paralizë cerebrale dhe fëmijërore ose paraplegjikë, si dhe persona me pengesa të rënda dhe tejet të rënda në zhvillimin psikik dhe në moshë mbi 26 vjeç.

- Ndhimë financiare e njehershme dhe ndihmë me mjete: Ndhimë financiare e njëfishtë ose ndihmë në mjete u sigurohet personave ose familjeve të cilët janë në situatë të riskut social, si rezultat i mbijetesës së katastrofës natyrore ose epidemi, periudhë më të gjatë të tretmanit në institut shëndetësor ose

krizë tjetër shoqërore. Ndhimë në mjete përfshin sigurimin e veshjes, ushqimit dhe mjete tjera të domosdoshme për ekzistencën minimale të qytetarëve dhe familjeve.

- e drejta e banimit është e rezervuar për personat socialisht të rrezikuar, gjegjësisht personat pa banim. Personat në vijim konsiderohen si socialisht të rrezikuar:
 - shfrytëzuesit e ndihmës financiare në vazhdimësi dhe
 - persona pa prindër ose kujdes prindëror deri në moshën 18 vjeçare dhe pas mbarimit të kujdestarisë, mirëpo jo më gjatë se pas moshës 26 vjeçare, me kusht të ndjekin mësim të rregullt.

Kriteret dhe mënyra e zbatimit të drejtës së banimit përcaktohen me akt të cilin e lëshojnë Këshilli i komunës, Këshilli i qytetit të Shkupit dhe i komunave në qytetin e Shkupit.

2. Objektiva e mijëvjeçarit 2: të arrihet arsim fillor universal – e drejta e njeriut për arsimim

2.1 Korniza ligjore ndërkombëtare

E DREJTA E ARSIMIMIT

- **Pakti ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore - viti 1966**
 - E drejta e të gjithëve për arsimim dhe qëllimet e arsimit- Neni 13/1
 - Arsimi fillor i obligueshëm dhe falas, arsimi i mesëm (duke e përfshirë arsimin profesional) dhe arsimi i lartë i qasshëm për të gjithë– Neni 13/2
 - Sistem i shkollave i qasshëm dhe kuadër i kualifikuar arsimor – Neni 13/2
 - E drejta e prindërve për zgjedhjen e shkollës, arsimit fetar dhe moral – Neni 13/3
 - Shkolla private dhe standarde minimale arsimore – Neni 13/4

- Plan për aksion për zbatimin progresiv – Neni 14

- **Konventa për të drejtat e fëmijës e KB, viti 1989**
 - E drejta e fëmijës për arsimim, duke përfshirë edhe Shtetin i cili duhet të motivojë ndjekjen e rregullt të mësimi/ të ndalojë braktisjen e mësimi – Neni 28/1
 - Arsimi fillor i obligueshëm dhe falas (pa pagesë), arsim të mesëm (duke përfshirë arsimin profesional) dhe arsimin e lartë të qasshëm për të gjithë, duke përfshirë edhe ndihmën financiare – Neni 28/1
 - Informata arsimore dhe orientim profesional, në dispozicion dhe të qasshme për të gjithë fëmijët – Neni 28/1
 - Disiplina shkollore e respekton dinjitetin njerëzor të fëmijës – Neni 28/2

- Bashkëpunim ndërkombëtar për punë që kanë të bëjnë me arsimin, të lehtësohet qasja deri te dijenia shkencore dhe profesionale dhe deri te metodat moderne arsimore – Neni 28/3
- Qëllime të arsimit, duke përfshirë zhvillimin e personalitetit të fëmijës, talente dhe aftësi; respekt për të drejtat e njeriut; respekt për identitetin kulturor personal të prindërve/ fëmijës, gjuhë, vlera; gatishmëri për jetë të përgjegjshme në shoqëri në shpirtin e paqes, tolerancës, barazia në mes gjinive; respektim i mjedisit natyror – Neni 29/1
- E drejta e themelimit të institucioneve private arsimore, standarde minimale arsimore – Neni 29/2
- E drejta e fëmijës për pushim dhe kohë të lirë, përfshirja në lojëra dhe aktivitete rekreative, participim i lirë në jetën kulturore dhe artistike, sigurimi i mundësive adekuate dhe të barabarta për aktivitete të lira kulturore, artistike, rekreative të fëmijës-neni 31
- **Konventa e KB-ve për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të gruas, viti 1979**
 - Eliminim i diskriminimit të gruas në arsim, duke e përfshirë edhe orientimin profesional, qasje në studime, bursa, programe arsimore, kuadër të kualifikuar, mjete- Neni 10
 - Eliminimi i stereotipeve, duke përfshirë edhe materialet dhe metodat arsimore - Neni 10
 - Ndalimi i braktisjes së shkollës nga fëmijët femra- Neni 10
 - Shanse të njëjta për participim aktiv në sport dhe edukatë fizike - Neni 10
 - Informata arsimore të cilat do të ndihmojnë dhe sigurojnë shëndetin dhe mirëqenien e familjeve, duke përfshirë edhe informata dhe këshilla për planifikimin e familjes - Neni 10
 - Mundësi të njëjta për qasje në programe për të rritur dhe programe për funksionalitet – Neni 10
- Qasje deri te të gjitha format arsimore dhe trajnim për femrat në vendet rurale - Neni 14
- **Konventa ndërkombëtare e KB-ve për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor, viti 1965**
 - Eliminimi i diskriminimit të grupeve të veçanta etnike lidhur me të drejtën e arsimit dhe trajnimit - Neni 5
 - Shteti të luftojë kundër paragjykimave në programin arsimor, arsim, kulturë dhe informatat të cilët çojnë kah diskriminimi, të promovojë tolerancë dhe mirëkuptim të të drejtave të njeriut - Neni 7
- **Konventa kundër diskriminimit në arsim e UNESCO-s, viti 1960**
 - Nuk duhet të ketë diskriminim në regjistrimin e nxënësve në institucionet arsimore, duke përfshirë edhe qasje të njëjtë për shtetasit e huaj të cilët jetojnë në atë territor - Neni 3
 - Standarde për kualitet në arsim dhe trajnim për profesionin arsimor pa diskriminim - Neni 4
 - Qëllimet e arsimit dhe të drejtat e prindërve - Neni 5/1
 - Të drejtat e pakicave nacionale lidhur me arsimin - Neni 5/1
- **Konventa nr. 138 e ILO-s për moshën minimale për punësim, e vitit 1973**
 - Shteti duhet të parashihet moshën minimale për praninë në punë ose punësim, në pajtueshmëri me moshën që është e nevojshme për kryerjen e arsimit të obligueshëm/ jo më pak se 15 vjet- Neni 2
- **Konventa nr. 182 e ILO-s për ndalim dhe aksion direkt për eliminimin e formave më të rënda të punës fëmijërore e vitit 1999**
 - Shteti të ndërmarrë masa efektive me data implementuese me qëllim që të ndalohet angazhimi i fëmijës në format më të këqija të punës fëmijërore; të identifikohen fëmijët të cilët ballafaqohen me rreziqe të veçanta; të sigurojë qasje të lirë deri te arsimi fillor; të ndihmojë në heqjen

e fëmijëve nga format më të rënda të punës fëmijërore; të parashikoj rehabilitim dhe integrim social; ta marrë parasysh situatën e veçantë të vajzave - Neni 7/2

- Bashkëpunim i përmirësuar ndërkom-bëtar dhe ndihmë për zhvillim, çrrën-josje të varfërisë dhe arsim universal - Neni 8
- **Protokolli i parë i Këshillit të Evropës kah Konventa për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, viti 1952**
 - Askujt nuk mund ti merret e drejta e arsimit; shteti ti respektojë të drejtat e prindërve lidhur me besimet e tyre religjioze dhe filozofike- Neni 2
- **Akti Sociale Evropiane e Këshillit të Evropës, viti 1961**

(në bazë të përpjekjeve të deklaruara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë sipas nenit 20 të Kartës Sociale Evropiane)

 - E drejta e fëmijës për mbrojtje nga eksploatimi ekonomik, duke përfshirë edhe sigurimin e moshës minimale për punësim, orari i punës, kontrolli mjekësor, trajnimi profesional, ndalimi i punës së natës- Neni 7 (me përjashtim të alinesë 5, i cili nuk është i miratuar nga Maqedonia)
- **Konventa kornizë për mbrojtjen e pakicave nacionale e Këshillit të Evropës, viti 1995**
 - Shteti duhet të motivojë tolerancë dhe dialog ndërkulturor dhe të promovojë respekt të ndërmjetshëm, mirëkuptim dhe bashkëpunim mes të gjithë personave të cilët jetojnë në territorin e saj pa dallim të identitetit etnik, kulturor, gjuhësor dhe religjioz të atyre personave posaçërisht në arsim, kulturë dhe media- Neni 6/1
 - Shteti ti mbrojë personat nga kërcënimet ose akte diskriminimi, armiqësi dhe dhunë si rezultat i identitetit të tyre etnik, gjuhësor ose religjioz- Neni 6/2
 - Të mirëmbahet dijenia në arsim dhe hulumtimi i kulturës, historisë, gjuhës

dhe religjionit të pakicave nacionale dhe të shumicës; të sigurohet trajnim adekuat i mësuesve, materialeve; mundësi të njëjta qasjeje në arsim në të gjitha nivelet për pakicat nacionale- Neni 12

- E drejta e personave të pakicave nacionale të themelojnë/udhëheqin institucion e tyre privat arsimor- Neni 13
- E drejta e anëtarëve të pakicave nacionale ta mësojnë gjuhën amtare dhe mundësi adekuate për mësimin e gjuhës së pakicave- Neni 14

Mbrojtja e të drejtave të fëmijës si kujdes primar

- **Konventa e KB-ve për të drejtat e fëmijës, viti 1989**
 - Interesat më të mira të fëmijës si kujdes primar në të gjitha veprimet të cilat i shqetësojnë ata, vlerësim i efektit mbi fëmijën dhe pjesëmarrja e fëmijës - Neni 3/1 и 12

Mosdiskriminimi i gruas dhe aksioni afirmativ

- **Konventa e KB-ve për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të gruas, viti 1979**
 - Shteti me mjete kompetente dhe pa asnjë anulim të ndjek një politikë të eliminimit të diskriminimit të gruas, duke përfshirë edhe legjislativwn, sanksionet dhe mbrojtjen ligjore dhe të sigurojë zhvillim të plotë dhe përparim të femrave në fushën ekonomike dhe sociale dhe të miratojw masa të përkohshme sociale të cilat do të kenë për qëllim ta përshpejtojnë barazinë faktike midis femrave dhe meshkujve- Nenet 2 deri më 4

Mosdiskriminimi i grupeve etnike dhe aksioni afirmativ

- **Konventa kornizë e Këshillit Evropian për mbrojtjen e pakicave nacionale, viti 1995**
 - Barazi të plotë dhe efektive ndërmjet pakicave nacionale dhe shumicës,

duke përfshirë të gjitha lëmit e jetës ekonomike dhe sociale - Neni 4/2

2.2. Korniza ligjore në Maqedoni

Kohëzgjatje e arsimit fillor

Arsimi fillor është me kohëzgjatje prej nëntë vjet.

Arsimi fillor është i obligueshëm

Arsimi fillor në bazë të ligjit është i obligueshëm për të gjithë fëmijët prej moshës 6 deri në moshën 15 vjeçare. Prindi ose kujdestari i fëmijës është i obliguar ta regjistrojë fëmijën në shkollë fillore dhe është përgjegjës për ndjekjen e rregullt të shkollës fillore nga ana e fëmijës

Propozim-rekomandime të propozuara nga KB për qasje kah të drejtat e njeriut lidhur me strategjitë për zvogëlimin e varfërisë, viti 2002

Rekomandimi 8: E drejta e arsimit

- **Qëllimi 1:** Sa më shpejtë të sigurohet arsim fillor universal për djem dhe vajza, por jo më vonë se në vitin 2015
- **Qëllimi 2:** Të mundësohet arsim fillor falas për të gjithë fëmijët
- **Qëllimi 3:** Të aprovohet arsimi fillor i obligueshëm
- **Qëllimi 4:** Të çrrënjohet analfabetizmi
- **Qëllimi 5:** Të sigurohet qasje e barabartë për të gjithë në arsimin e mesëm
- **Qëllimi 6:** Të sigurohet arsim i mesëm falas për të gjithë fëmijët
- **Qëllimi 7:** Të eliminohet dallimi mes gjinive në arsimin fillor dhe të mesëm
- **Qëllimi 8:** Të përmirësohet kualiteti i arsimit fillor dhe të mesëm

Arsimi fillor përfshin:

- vitin hyrës;
- katër vite program klasor; dhe
- katër vite program lëndor.

Programi klasor është prej klasës së parë deri në të katërtën, kurse programi lëndor prej klasës së pestë deri në klasën e tetë të arsimit fillor.

Viti hyrës në arsimin fillor

Në vitin hyrës të arsimit fillor të obligueshëm (në tekstin e mëtutjeshëm: viti hyrës) regjistruhen të gjithë fëmijët të cilët deri në fund të vitit kalendarik do të mbushin 6 vjet. Nëse me raport mjekësor vërtetohet se fëmija nuk është sa duhet i zhvilluar fizikisht ose mentalisht, ai përkohësisht lirohet nga obligimi për t'u regjistruar në atë vit. Në vitin hyrës mund të regjistruhen fëmijët të cilët deri në fillimin e vitit shkollor do të kenë mbushur 5 vjet të bazuar në mendimin pozitiv nga mjek-specialist, psikolog ose pedagog.

Transporti falas, sistemimi dhe ushqimi në arsimin fillor

Nxënësi ka të drejtë të ketë transport falas deri në shkollë nëse largësia ndërmjet vendit të banimit dhe shkollës më të afërt, është më e madhe se 2 km. Nxënësit me nevoja të posaçme, kanë të drejtë të shfrytëzojnë transport falas. Nëse transporti nuk mund të sigurohet, nxënësi ka të drejtë sistemimi dhe ushqimi falas në internatet shkollore ose në familje..

Llojet e shkollave të mesme

Arsimi i mesëm zbatohet në shkollat e mesme. Këto shkolla janë ose publike ose private. Shkollat publike mund t'i themelojë ose komuna ose shteti (shkollat private dhe ato shtetërore nuk janë të përfshira/mbuluara me procesin e decentralizimit). Shteti mund të ojë shkollë të mesme për kategori të caktuara të nxënësve ose për fusha me interes të veçantë për vetë shtetin (art, muzikë, shkolla për fëmijë me handikap etj.).

Mosdiskriminimi në arsimin e mesëm

Secili person, në kushte të barabarta, gëzon të drejtën e arsimimit të mesëm. Nuk lejohet diskriminimi në bazë të gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, nacionalitetit dhe origjinës sociale, bindjeve politike dhe religjioze, statusit financiar dhe social.

Gjuha në arsimin fillor dhe atë të mesëm

Procesi arsimor në shkollat fillore dhe ato të mesme, zhvillohet në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik. Për anëtarët e komuniteteve që vijnë në mësimin në gjuhë

të ndryshme nga maqedonishtja, procesi arsimor zhvillohet në gjuhën dhe alfabetin e atij komuniteti, në mënyrën e caktuar me këtë ligj.

Arsim – politikë – religjion

Në shkollat fillore dhe ato të mesme ndalohen të gjitha llojet e organizimit politik dhe religjioz. Nuk lejohet zbatimi i arsimit religjioz në shkollat fillore dhe ato të mesme. Ndalohet vendosja e simboleve të partive politike dhe simboleve religjioze në shkollat fillore.

3. Objektivi zhvillimor i mijëvjeçarit 3: të promovohet barazia gjinore dhe të përforcohen gratë - të drejtat e njeriut të gruas dhe barazia gjinore

3.1 Korniza ligjore ndërkombëtare

Të drejtat njerëzore të gruas dhe barazia gjinore

- **Konventa e KB-ve për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të gruas, viti 1979.**

Vërejtje: Këtu është e rëndësishme e tërë konventa; megjithatë, pjesët dhe dispozitat në vijim janë theksuar për shkak të relevancës së tyre të veçantë në kontekstin maqedonas

- Shteti me mjete kompetente dhe pa asnjë anulim të ndjek një politikë të eliminimit të diskriminimit të gruas, duke përfshirë edhe legjislativën, sanksionet dhe mbrojtjen ligjore - Neni 2
- Të modifikohen formularët social dhe kulturor të sjelljes së meshkujve dhe femrave/paragjykime/stereotipe dhe praktikatat relevante duke e përfshirë edhe arsimin familjar- Neni 5
- Përpara ligjit të përputhet barazia mes femrave dhe meshkujve dhe kapaciteti i plotë juridik me meshkujt, dhe të sigurohen të drejta të njëjta në sferën e martesës, lidhjeve familjare dhe pronës – Nenet 15 dhe 16

- Eliminimi i diskriminimit të gruas në arsim, duke përfshirë edhe qasjen në programet për të rritur dhe programe për edukim - Neni 10
- Eliminimi i diskriminimit të gruas në fushën e punësimit - Neni 11
- Eliminimi i diskriminimit të gruas në fushën e mbrojtjes shëndetësore - Neni 12
- Eliminimi i diskriminimit të gruas në jetën kulturore - Neni 13
- Pjesëmarrje në jetën politike dhe publike, në nivel nacional dhe ndërkombëtar - Nenet 7 dhe 8
- Eliminimi i diskriminimit të gruas lidhur me nacionalitetin - Neni 9
- Çrrenjosja e të gjitha formave të tregtisë me femra dhe eksploatim të prostitucionit - Neni 6
- Eliminimi i diskriminimit posaçërisht në aspekt të femrave nga vendet rurale - Neni 14

- **Konventa e KB-ve për të drejtat e fëmijës, viti 1989**

- Të garantohet mosdiskriminim në bazë gjinore – Neni 2
- Edukimi dhe zhvillimi i fëmijës si obligim i të dy prindërve - Neni 18

- Qasje deri te shërbimet konkrete shëndetësore për nënat: çrrënjësja e praktikave tradicionale të besëtytnive për shëndetin e fëmijëve - Nenet 24/2 dhe 24/3
- **Pakti ndërkombëtar për të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore - viti 1966.**
 - Shteti të garantojë të drejta të barabarta për meshkujt dhe femrat për të gëzuar të gjitha të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore - Neni 3
 - E drejta e punës dhe rrogës së njëjtë për punë të njëjtë - Nenet 6 dhe 7
 - Qasje në arsim për të gjithë - Nenet 13 dhe 14
- **Pakti i KB-ve për të drejtat qytetare dhe politike - viti 1966.**
 - Shteti të garantojë të drejta të barabarta për meshkujt dhe femrat në lidhje me të drejtat qytetare dhe politike - Neni 3
 - Nuk mund të ekzekutohet dënimi me vdekje mbi femrat shtatzëne - Neni 6/5
 - Barazi mes meshkujve dhe femrave lidhur me martesën dhe lidhjet familjare - Neni 23
 - E drejta e barabartë e votës dhe e drejta për të qenë e zgjedhur dhe të ketë qasje deri te shërbimet publike - Neni 25
 - Ndalimi i diskriminimit në bazë të gjinisë - Neni 26
- **Konventa ndërkombëtare e KB-ve për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor, viti 1965.**
 - E drejta e të gjithëve për barazi para ligjit lidhur me të drejtat qytetare, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore - Neni 5
- **Konventa e UNESCO-s kundër diskriminimit në arsim, viti 1960**
 - Të eliminohet dhe të ndalohet diskriminimi në arsim në bazë të gjinisë - Nenet 3 dhe 1

- **Konventa për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore e Këshillit Evropian (ECHR), viti 1950 dhe protokollin nr. 12, viti 2000**

- Të drejtat e konventës të garantohen pa kurrfarë diskriminimi në bazë gjinore - Neni 14 i ECHR.
- Ndalim i përgjithshëm i diskriminimit, duke përfshirë edhe atë që i referohet gjinisë - Neni 1 P12

Akti Social Evropian i Këshillit Evropian, viti 1961

(lidhur me premtimet e deklaruara të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë në bazë të nenit 20 nga Akti Social Evropian)

- Të drejtat e grave të punësuar në mbrojtje, duke përfshirë edhe dispozitat për pushim para/pas lindjes, përkujdesja për foshnjat, ndalimi i disa formave specifike të punës - Neni 8
- E drejta e nënave dhe fëmijëve për mbrojtje konkrete sociale dhe ekonomike - Neni 17

Mbrojtja e të drejtave të fëmijës si kujdes primar

- **Konventa e KB-ve për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, viti 1989**
 - Interesat më të mira të fëmijës si kujdes primar në të gjitha veprimet të cilat e shqetësojnë fëmijën, vlerësim i efektit mbi fëmijën dhe pjesëmarrja e fëmijës - Neni 3/1 i 12

Mosdiskriminimi i grupeve etnike dhe aksioni afirmativ

- **Konventa kornizë për mbrojtjen e pakicave nacionale e Këshillit të Evropës, viti 1995**
 - Barazi të plotë dhe efektive në mes pakicave nacionale dhe shumicës, duke përfshirë të gjitha sferat e jetës ekonomike dhe sociale - Neni 4/2

Propozime-rekomandime të KB-ve për qasje deri te të drejtat e njeriut lidhur me strategjitë për zvogëlimin e varfërisë, viti 2002

Rekomandimi 6: E drejta e ushqimit adekuat

- **Qëllimi 2:** Eliminimi i pabarazisë gjinore në qasjen deri te ushqimi

Rekomandimi 7: E drejta e mbrojtjes shëndetësore

- **Qëllimi 7:** Eliminimi i pabarazisë gjinore në qasjen deri te mbrojtja shëndetësore

Rekomandimi 8: E drejta e arsimit

- **Qëllimi 1:** Sa më shpejtë të sigurohet arsim themelor universal për djemtë dhe vajzat, por jo më vonë se 2015
- **Qëllimi 5:** Të sigurohet qasje e barabartë për të gjithë në arsimin e mesëm
- **Qëllimi 7:** Të eliminohet dallimi mes gjinive në arsimin fillor dhe të mesëm

Rekomandimi 9: E drejta e punës së ndershme

- **Qëllimi 4:** Të eliminohet pabarazia gjinore në qasjen e punës
- **Qëllimi 5:** Të eliminohet pabarazia lidhur me rrogat

Rekomandimi 11: E drejta e sigurisë personale

- **Qëllimi 1:** Të eliminohet dhuna mbi të varfrit nga ana e aktorëve shtetëror dhe jo shtetëror

Rekomandimi 13: E drejta e qasjes të barabartë në drejtësi

- **Qëllimi 1:** Qasje e barabartë e drejtësisë civile për viktimat të cilat janë të varfra

3.2 Korniza ligjore në Maqedoni

Sa u takon të drejtave të grave, janë marrë parasysh pikat në vijim:

Mundësi të njëjta për punë

Në pajtueshmëri me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë (Neni 32, alineja 1) secili ka të drejtë të punojë, të ketë zgjedhje të lirë të vendit të punës, të ketë mbrojtje në vendin e punës, të ketë ndihmë materiale gjatë papunësisë së përkohshme; secila punë është e hapur për të gjithë me kushte të barabarta, pa kurrfarë diskriminimi, duke përfshirë edhe diskriminimin gjinor

Ndalohet largimi nga puna për shkak të shtatzënisë, pushimit të lindjes ose kujdesit prindëror

Punëdhënësi nuk mund ta prish kontratën për punë të të punësuarve të gjinisë femërore gjatë kohës së shtatzënisë, mung-

esës lindore dhe kujdesit prindëror dhe për shkak të obligimeve për përkujdesje të fëmijës.

E drejta e gruas për të ardhura të barabarta

Punëdhënësi, pa dallim të gjinisë, duhet të jetë i obliguar t'u japë të ardhura të barabarta mujore të punësuarve për punë në vende të njëjta pune me obligime të njëjta.

Dispozitat e kontratave të punës, kontratave kolektive dhe/ose rregulloreve të përgjithshme të punëdhënësit të cilat janë në kundërshtim me atë që është përmendur më sipër, do të anulohen

E drejta për arsimim

E drejta për arsimim që është e garantuar me Kushtetutën, ndërthet në vete norma me të cilat ndalohet diskriminimi. Secili individ ka të drejtë të fitojë arsim të mesëm në kushte të njëjta. Diskriminimi i bazuar në

Legjislativa kyçe

- Ligji për kushtet e punës, Gazeta zyrtare nr. 50/97, 16/2000, 17/2003, 28/04
- Ligji për sigurim pensional dhe invalidor, Gazeta zyrtare nr. 80/93, 3/94, 14/95, 35/95, 40/96, 70/96, 71/96, 24/97, 25/97, 32/97, 96/00, 98/00 и 5/2001
- Ligji për shëndetësi, Gazeta zyrtare nr. 17/97, 20/04
- Ligji për sigurim shëndetësor, Gazeta zyrtare nr. 25/2000, 34/2000, 96/2000, 50/2001, 11/2002, 31/2003 dhe vendimi i Gjyqit Kushtetues nr. 104/2000 и 48/2001
- Ligji për arsim fillor, Gazeta zyrtare nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 63/2004, 82/2004 dhe 55/2005
- Ligji për arsim të mesëm, Gazeta zyrtare nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004 и 55/2005
- Ligji për arsim të lartë, Gazeta zyrtare nr. 34/2000, 113/05
- Ligji për familje, Gazeta zyrtare nr. 83/04
- Ligji për punësim dhe sigurim në rast papunësie, Gazeta zyrtare nr. 37/97, 25/2000, 101/2000, 50/01, 25/03, 37/04, 4/05
- Ligji për nënshtetësi, Gazeta zyrtare nr. 45/04
- Ligji për mbrojtje shëndetësore, Gazeta zyrtare nr. 17/97
- Ligji Penal, Gazeta zyrtare nr. 37/96 me adaptim, me datë 26. 09 2005

gjini dhe racë, ngjyrë të lëkurës, prejardhje sociale dhe nacionale, bindje politike dhe religjioze, status financiar dhe social, nuk është i lejuar.

Diskriminimi është i ndaluar edhe në nivelet më të larta të arsimit d.m.th. të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë kanë të drejtën e arsimit të lartë në kushte të barabarta.

3.2.1 Gjinia dhe shëndetësia

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, i garanton secilit qytetar të drejtën e mbrojtjes shëndetësore. Si shtesë, çdo qytetar i Republikës së Maqedonisë, ka të drejtë dhe obligim ta ruaj dhe mirëmbajë shëndetin e tij dhe shëndetin e tjerëve. Këto rregullore të Kushtetutës janë të inkorporuara në ligjin për mbrojtje shëndetësore dhe ligjin për sigurim shëndetësor.

4. Objektivat zhvillimore të mijëvjeçarit 4: të zvogëlohet vdekshmëria te fëmijët - e drejta e fëmijës për shëndet

4.1 Korniza ligjore ndërkombëtare

- **Konventa për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës e KB, viti 1989**

- E drejta e fëmijës ta ketë standardin më të lartë të shëndetit dhe të institucioneve për trajtimin e sëmundjes dhe rehabilitim të shëndetit, duke përfshirë edhe qasjen jo diskriminuese deri te shërbimet e till - Neni 24/1
- Shteti ta zvogëlojë vdekjen e foshnjave dhe të fëmijëve- Neni 24/2
- Shteti të sigurojë ndihmë mjekësore të nevojshme, theks në mbrojtjen shëndetësore primare, lufta kundër sëmundjeve dhe të ushqyerit e mjaftueshëm përmes qasjes deri te ushqimi, uji i pastër për pije, mbrojtja nga ndotja ekologjike- Neni 24/2
- Mbrojtje shëndetësore adekuate parinatale/postnatale për nënat, duke i përfshirë nënat e moshës së mitur – Neni 24/2
- Informata shëndetësore dhe edukim për shëndetin e fëmijës, ushqimi, dhënia e gji, higjiena, masat shëndetësore, prevenimi i aksidenteve, i qasshëm për të gjithë, përfshirë këtu edhe fëmijët- Neni 24/2
- Mbrojtje shëndetësore preventive, rekomandime për prindërit si dhe edukim dhe shërbime për planifikimin e familjes- Neni 24/2
- Shteti duhet t'i ndërpret praktikat tradicionale të besëtytnive për shëndetin e fëmijës - Neni 24/3
- Bashkëpunim ndërkombëtar për realizimin e të drejtës së fëmijës për shëndet - Neni 24/4
- Qasje efektive e fëmijës me handicap dhe shërbimet për rehabilitim,

dhe bashkëpunim ndërkombëtar dhe këmbim i informatave për mbrojtjen shëndetësore preventive dhe trajtim mjekësor, psikologjik dhe funksional të fëmijëve me handicap - Neni 23

- E drejta e fëmijës për revizion periodik të çfarë do qoftë sistemi të fëmijëve me qëllim të përkujdesjes, mbrojtjes dhe trajtimit shëndetësor të tyre fizik dhe mental - Neni 25
- E drejta e fëmijës për jetë, mirëmbajtje dhe zhvillim - Neni 6
- Shteti t'i mbrojë të gjithë fëmijët nga të gjitha format e dhunës mentale dhe fizike, lëndimi dhe keqtrajtimi, lënia pas dore dhe sjellja johumane, maltretimi dhe eksploatimi, duke përfshirë edhe keqpërdorimin seksual deri sa janë nën kujdesin e prindërve/personave tjerë përgjegjës- Neni 19
- Shteti të promovojë kurim fizik dhe psikik, si dhe reintegrim social të fëmijës-viktimë e çfarëdo qoftë forme të dhunës - Neni 39
- Shteti t'i mbrojë të gjithë fëmijët nga eksploatimi ekonomik/çfarëdo qoftë pune të rrezikshme ose të dëmshme - Neni 32
- Shteti t'i mbrojë të gjithë fëmijët nga përdorimi ilegal i mjeteve narkotike dhe substancave psikotropike - Neni 33
- Shteti të garantojë standarde për kualitet (siguri, shëndet, kualifikime të të punësuarve) për të gjithë institucionet dhe shërbimet kompetente për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve - Neni 3/3
- Interesat më të mira të fëmijës si kujdes primar në të gjitha veprimet të cilat i shqetësojnë fëmijët, vlerësim i ndikimit mbi fëmijët- Neni 3/1

- Participimi i fëmijës në të gjitha çështjet të cilat ndikojnë mbi të - Neni 12/1
 - Mosdiskriminimi i fëmijës të bazuar në prejardhjen sociale, pronës - Neni 2
 - Përgjegjësi e shtetit për mbrojtjen dhe kujdesin e fëmijëve dhe resurseve maksimale për zbatimin e të drejtave ekonomike dhe sociale të fëmijës - Nenet 3/2 dhe 4
 - Përgjegjësi primare e të dy prindërve për edukim dhe zhvillim të fëmijës dhe përkrahje e shtetit për prindërit, duke i përfshirë edhe shërbimet për përkujdesjen e fëmijëve dhe kujdes alternativ për fëmijët larg familjeve të tyre - Nenet 5, 18 dhe 20
- **Pakti ndërkombëtar i KB-ve për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, viti 1966**
 - E drejta e të gjithëve të kenë standardin më të lartë të mundshëm të shëndetit mental dhe fizik - Neni 12/1
 - Zvogëlimi i nivelit të foshnjave të cilat lindin të vdekura dhe të vdekjes së foshnjave të sapolindura, përkrahje për zhvillim të shëndetshëm të fëmijës - Neni 12/2
 - Prevenim, trajtim dhe kontroll i epidemive, endemive, sëmundjeve profesionale dhe sëmundjeve të tjera - Neni 12/2
 - Përmirësim i të gjitha aspekteve të higjienës ekologjike dhe industriale - Neni 12/2
 - Shërbim mjekësor dhe kujdes mjekësor për të gjithë në rast sëmundjeje - Neni- 12/2
 - Kujdes i posaçëm për nënat në periudhën përpara dhe pas lindjes - Neni 10/2
 - Masa të posaçme për mbrojtjen dhe ndihmën e të gjithë fëmijëve dhe të rinjve pa kurrfarë diskriminimi - Neni 10/3
 - E drejta e përfitimit nga përparimi i shkencës dhe implementimi i saj - Neni 15/1
 - **Pakti i KB-ve për të drejtat qytetare dhe politike, viti 1966**
 - E drejta inherente e jetës së të gjithëve - Neni 6/1
 - Eksperimentim i ndaluar mjekësor dhe shkencor pa pajtueshmëri të lirë - Neni 7
 - Mbrojtje e posaçme dhe ndihmë për fëmijët pa kurrfarë diskriminimi - Neni 24
 - **Konventa e KB-ve për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor, viti 1965.**
 - Eliminimi i të gjitha formave të diskriminimit të grupeve etnike lidhur me të drejtën e tyre për mbrojtje mjekësore në shëndetësinë publike - Neni 5
 - Eliminimi i diskriminimit të grupeve etnike lidhur me të drejtën e sigurisë së personit dhe mbrojtje nga shteti kundër dhunës ose lëndimit të lehtë trupor - Neni 5
 - **Konventa e KB-ve për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të gruas, viti 1979.**
 - Eliminimi i diskriminimit të gruas në lëmin e mbrojtjes shëndetësore, duke përfshirë edhe qasjen në shërbimet për planifikimin e familjes - Neni 12
 - Eliminim i diskriminimit të gruas në arsim, duke përfshirë edhe participimin aktiv në sport dhe arsim fizik; dhe qasje në informata konkrete arsimore të cilat do të ndihmojnë të sigurohet shëndeti dhe mirëqenia e familjeve, duke përfshirë edhe informata dhe këshilla për planifikimin e familjes - Neni 10
 - Qasja deri te institucionet adekuate shëndetësore, informata, këshillime dhe shërbime për planifikimin e familjes për gratë në vendet rurale - Neni 14

- **Konventa e Këshillit të Evropës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, 1950.**
